

Planifikimi Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024



	Faqe
Hyrje	3
KAPITULLI I Procesi i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Roli i tij	4
KAPITULLI II Prioritetet Afatmesme 2022 – 2024	6
KAPITULLI III Parashikimet Buxhetore Afatmesme 2022 – 2024	18
III.1 Të Ardhurat e Bashkisë së Tiranës për Periudhën 2022 – 2024	18
III.2 Transfertat nga Buxheti i Shtetit	40
III.3 Burime të tjera financimi / Donacione	43
III.4 Parashikimi i shpenzimeve për Periudhën 2022 – 2024	46

HYRJE

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike.

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë së Tiranës është hartuar në bazë të funksioneve të pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin referuar dhe udhëzimit nr. 7 datë 26.02.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024", udhëzimit plotësues nr.20 datë 09.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024" edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia e Tiranës.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet të sanksionohet një proces për të administruar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Projekt-buxhetet bazohen në vizionin tonë për Tiranën e së ardhmes, e cila para së gjithash duhet të jetë një qytet i jetueshëm, me infrastrukturë moderne e transport publik cilësor, me shërbime efikase e cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore të larmishme e me hapësira të dedikuara për fëmijët, të moshuarit, këmbësorët e çiklistët. Sektorët parësorë të zhvillimit dhe prioriteti i shpërndarjes së burimeve për periudhën 2022-2024, bazohen në programin qeverisës të Kryetarit të Bashkisë për vitet 2019-2022, i reflektuar në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë.

KAPITULLI I

PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të ndërthurur informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve dhe përcakton objektivat se si do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Hartimi i PBA-së përbën një proces të rëndësishëm për Bashkinë e Tiranës, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Strategjinë e Bashkisë së Tiranës, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësisia vendore ofron për banorët.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Qëllimet dhe Objektivat e Programit:

- a. Përmirësimi i menaxhimit dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike, është objektivi parësor i PBA-së.
- b. Sigurimi i një shpërndarjeje të drejtë efiçente të burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore.

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit* synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, si dhe treguesit e performancës. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të klasifikimit të shpenzimeve të njësive vendore sipas sistemit ndërkombëtar COFOG, ku çdo funksion lidhet me disa programe, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative , të mirëmbajtjes etj),
- b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e varësisë

KAPITULLI II

PRIORITETET AFATMESME 2022-2024

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2022-2024 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Tiranës, në Programin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2019-2023 dhe në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë.

➤ **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Objektivi themelor i PBA-së 2022-2024 do të jetë garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të Tiranës, për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm e për të garantuar mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Programet Buxhetore të deritanishme kanë arritur tashmë objektivat e rikthimit të Tiranës në punë dhe kthimit të saj në një qytet të jetueshëm. Kanë përfunduar disa nga projektet e mëdha strategjike; është ndërhyrë në pjesën dërrmuese të lagjeve të qytetit me projekte rigjenerimi urban; është siguruar pastërtia e qytetit dhe reduktuar ndotja; janë shtuar sipërfaqet e gjelbëra; është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në të gjithë çerdhet e kopshtet e qytetit; janë krijuar hapësira të reja rekreacionale; është rigjallëruar jeta kulturore dhe masivizimi i sporteve.

Në vijim të Strategjisë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë, në të cilën është mbështetur hartimi i buxhetit për tre vitet e ardhshme, dhe duke e plotësuar edhe në përputhje me të gjitha ndryshimet e emergjencat me të cilat është përballur qytetit në vitet e fundit si tërmeti dhe pandemia, janë parashikuar **7 qëllimet** kryesore të programit, të zbërthyer në disa objektiva specifike:

1. **Infrastrukturë urbane e qëndrueshme:**

Bashkia e Tiranës do të maksimizojë sigurimin e infrastrukturës zhvillimore, kritike dhe sociale që të jetë në proporcion të drejtë me shkallën e zhvillimit dhe të zgjerimit të popullsisë në qytet. Vendndodhja dhe shkalla e rritjes do të identifikohen përmes Planeve të Zhvillimit, si edhe përmes menaxhimit e vlerësimit të nevojave. Kapaciteti i infrastrukturës, duke pasur parasysh rritjen e identifikuar në Planin e Zhvillimit, do t'i ofrojë infrastrukturën e nevojshme njësisive. Bashkia gjithashtu do të marrë në konsideratë ndikimin kumulativ të propozimeve të shumta zhvillimore në një zonë. Futja deri në kapilaret dytësorë të përmirësimit të infrastrukturës urbane dhe sociale do t'i japë një zhvillim më të madh njësisive e lagjeve të kryeqytetit. Kjo gjë synohet të arrihet nëpërmjet:

- Rehabilitimi dhe mobilimit urban të njësisive;
- Përmirësimi i hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndricim etj;
- Përmirësimi I infrastrukturës së munguar për asetet e qytetit;
- Ndërtimi i infrastrukturës për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm dhe për të mbrojtur mjedisin.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë së Tiranës për t'iu përgjigjur sfidave të mundshme në të ardhmen.
- Optimizimi i Infrastrukturës kritike.
- Investime dhe rehabilitim/zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe rritja e mbulimit me shërbimin;
- Zgjerim i kanaleve nëntokësore dalëse për eliminimin e ujrave të ndotura

2. **Arsimi për të gjithë:**

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë një objektiv strategjik edhe për vitin 2022. Gjithashtu Bashkia e Tiranës i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbytur vizionit të saj dhe atij kombëtar. Rezidencat universitare do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së BT edhe për këtë vit duke qenë se Tirana akomodon numrin më të lartë të studentëve në të gjithë Shqipërinë, kjo jo vetëm për faktin se në kryeqytete janë përqëndruar numri më i madh i institucioneve të arsimit të lartë por sepse metropoli ofron më shumë mundësi për punësim. BT synon të nxisë shfrytëzimin maksimal të hapësirave të këtyre objekteve në funksion të edukimit dhe ndërveprimit të komunitetit nëpërmjet programit “Shkolla si Qendra Komunitare”.

- Ndërtimi i shkollave të reja;
- Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së procesit mësimor;
- Infrastrukturë e re sipas standarteve si në zonat urbane edhe rurale;
- Infrastrukturë ekzistuese e përmirësuar
- Rritja e sigurisë në rrugë e në objektet shkollore.
- Rritja e Aksesit dhe gjithëpërfshirjes në Arsimin Parauniversitar;
- Rritja e aksesueshmërisë për grupet e pafavorizuara;
- Shkollat si qendra komunitare.

3. **Zhvillimi i Ekonomisë së qëndrueshme në qytet:**

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qëndrueshmëri në të ardhmen, janë parashikuar programe e projekte që synojnë përmirësimi e cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset, mbështetje financiare dhe incentiva fiskale, rritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja.

- Nxitja e zhvillimit ekonomik, punësimit e sipërmarrjes;
- Nxitja e zhvillimit rural dhe turizmit dhe ndihmesë bujqësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.
- Zhvillimi i biznesit local, inovacionit dhe bizneseve të gjelbra dhe qarkulluese
- Përmirësimi i aftësive për punë;
- Zhvillimi i qytetit me focus tek Techno-hub
- Implementimi i Zonës së Lirë Ekonomike (TEDA Kashar) për thithjen e investimeve të huaja.

4. **Tirana qytet i rimëkëmbur nga tërmeti dhe pandemia dhe më i jetueshëm**

Ndërkohë që efektet e pandemisë globale Covid-19, gjatë viteve 2020 dhe 2021, prekën ekonominë e të gjitha vendeve, duke cënuar në këtë mënyrë proceset e zhvillimit, Shqipëria u përball njëkohësisht me pasojat e tërmetit të 26 Nëntorit 2019, situata të cilat kanë sjellë të nevojshme riorientimin e objektivave strategjike.

Nga ana tjetër, programet e rindërtimit që nisën në fund të vitit 2019, për rindërtimin e banesave individuale dhe njësisive të banimit si dhe ndërtimin e infrastrukturës arsimore e publike të dëmtuar nga tërmeti, kanë krijuar premisa për ndërhyrje në infrastrukturë publike

përtej këtyre nevojave duke i dhënë kështu qytetit mundësi për një zhvillim urban dhe ekonomik që do të ndihmojë rimëkëmbjen ekonomike në vitet pasardhëse.

Nëpërmjet këtij objekti, synohet përmirësimi i një sërë elementesh me impakt të drejtpërdrejtë tek çdo grupmoshë e popullsisë që përfshihen në territorin e BT-së. Vëmendje edhe për këtë vit do të kenë rehabilitimet e blloqeve të banimit si dhe nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi.

- Rindërtimi i Lagjeve të reja nga Tërmeti: 5 Maji, Kombinati, Vaqarri, Ndroqi, Peza, Baldushku dhe Zallherri,
- Mirëmenaxhimi i emergjencave natyrore / klimaterike/ përmbytjeve / tërmeteve / zjarreve
- Tirana qytet 24 h non stop
- Rivitalizimi i jetës kulturore, artistike, sportive, jetës së natës, gjithë sektorëve kreativë dhe Turizmit
- Rimëkëmbje për një qytet më të gjelbër, më të pastër, më të barabartë, më të aksesueshëm, dhe më të sigurt
- Përmirësimin e shërbimit të varrezave publike;
- Ofrimit të shërbimeve sociale cilësore;
- Rritjes së sipërfaqeve të gjelbra e parqeve dhe shtimit të hapësirave rekreacionale;

5. Transporti për të gjithë:

Transporti për të gjithë përbëhet nga një grup politikash me fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së qytetit nga të gjithë.

Ky objektivi është një ndër më sfiduesit dhe synon të nxisë mobilitetin alternativ nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të korsive të dedikuara për biçikleta dhe përmirësimin të shërbimit të operatorëve në këtë fushë, të përmirësojë situatën e parkimit nëpërmjet rritjes së kapacitetit dhe përdorimit eficient të hapësirave ekzistuese dhe përmirësimin të shërbimit të parkimit me pagesë. Vëmendje të vecantë do të ketë edhe transporti publik ku do të punohet që të garantohet një sistem transporti i sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe me efikasitet të lartë për distanca mbi 5 km si dhe përmirësimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë në qytet. Ky objektivi do të arrihet konkretisht nëpërmjet:

- Nxtjes së mobilitetit alternativ dhe të qëndrueshëm për rritjen e aksesueshmërisë;
- Përmirësimi i rrjetit rrugor urban, me fokus të posacëm tek korsitë e bicikletave dhe trotuarët;
- Përmirësimi i transportit publik duke futur dhe teknologjitë e reja;
- Rritjen e kapacitetit të parkimit në qytet dhe përdorimit eficient të hapësirave ekzistuese;

6. Qeverisja e mirë:

BT ka përcaktuar si prioritet të saj forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve i cili do të realizohet nëpërmjet 3 programeve:

- *Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit nëpërmjet:*
 - Dixhitalizimit të sistemeve të ofrimit të shërbimit;
 - Përfshirjen në sistemin e One Stop Shop të njësive administrative për të ofruar shërbimin sa më afër qytetarit;

- Ri-optimizimin dhe Standartizimi i proceseve të punës të strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë për të lehtësuar procedurat dhe menaxhuar me eficence më të lartë cdo proces pune në institucionin e Bashkisë;
- *Rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve në vendimmarrje nëpërmjet:*
 - Përmirësimin e portalit Tirana Ime;
 - Përmirësimin e raportimit tek qytetarët dhe rritjen e përfshirjen së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nëpërmjet ngritjes së një rrjeti më të mirë komunikimi me qytetarët për punët dhe projektet e Bashkisë;
- *Administrimin më të mirë të të ardhurave të Bashkisë:*
 - Rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe të kontrollit financiar;
 - Ruajtja e qëndrueshmërisë financiare së Bashkisë Tiranë;
 - Reduktimin e shpenzimeve administrative të Bashkisë nëpërmjet përmirësimit të Standarteve e të proceseve të punës brenda institucionit;

7. Investim afatgjatë për Rininë - Tirana si Kryeqyteti European i Rinisë

Në vitin 2019 Bashkia e Tiranës u nderua me “Kryeqytetin Rinor Evropian 2022” nga Forumi Rinor Evropian. Me këtë rast, gjatë gjithë vitit 2022, Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, OSHC-të rinore, si dhe përfaqësues të sektorit publik dhe privat do të organizojnë një sërë aktiviteteve që synojnë të stimulojnë të rinjtë për t'u bërë më proaktivë për çështjet që shqetësojnë. ata, më të etur për të shfrytëzuar mundësitë ekzistuese për rritje personale dhe profesionale, ndërkohë që kuptojnë fuqitë e tyre të vërteta si ndryshim-bërës. Aktivitetet, të cilat do të bazohen në 8 tema kryesore që konsistojnë në ekonominë krijuese dhe inovacionin, kulturën, ngritjen e kapaciteteve, pjesëmarrjen, diversitetin, identitetin evropian, eko-shëndetin dhe hapësirat publike, synojnë si më poshtë:

- Mbështetja e krijimtarisë dhe inovacionit të të rinjve në teknologji dhe dizajn, asistimi në zhvillimin e planeve të biznesit dhe mbështetja e OJQ-ve rinore përmes skemave të granteve për të krijuar punësim.
- Promovimi i kulturës urbane përmes festivaleve të muzikës dhe filmit, arteve murale dhe rrugës dhe ngjarjeve të tjera kulturore.
- Promovimi i formimit profesional dhe zhvillimit të punës ekipore duke ndërtuar aftësi të buta nëpërmjet mjeteve të edukimit joformal.
- Inkurajimi i të rinjve që të angazhohen më shumë në jetën e komunitetit, të dalin vullnetarë dhe të thonë fjalën e tyre në vendimmarrjen lokale.
- Inkurajimi i dialogëve për diversitetin dhe tolerancën përmes eventeve të dedikuara për rëndësinë e bashkëjetesës.
- Promovimi i vlerave evropiane përmes aktiviteteve artistike dhe rrjetëzimit si netët evropiane të filmit, shkëmbimet e Rrugës Rinore, etj.
- Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm, aktiv dhe social përmes një sërë aktiviteteve gjithëpërfshirëse në natyrë me fokus në shëndetin mendor dhe lehtësimin e stresit.
- Shtimi i burimeve të reja hapësinore dhe hapësirave publike ekzistuese të decentralizuara duke theksuar rëndësinë e tyre në rritjen e lidhjes së të rinjve.

► Projekte Strategjike:

Pas një sërë projektesh strategjike që rigjallëruan jetën e qytetit gjatë mandatit të parë qeverisës si, Projekti i Rigjenerimit Urban të Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi; Projekti i Bulevardit të ri, Sheshi Skënderbej, Rehabilitimi i Parkut të Madh të Tiranës, po vijohet me projekte të reja strategjike të cilat synojnë jo vetëm përmirësimin e infrastrukturës por edhe rritjen ekonomike, zhvillime teknologjike dhe rritjen e punësimit në qytet.

PIRAMIDA

Krijimi i një Qendre për Edukimin për Teknologjinë do të jetë koncepti bazë i përdorimit të Piramidës. Kjo qendër do të jetë një mjedis ku do të ndërveprojnë të rinjtë duke përdorur teknologjinë më të mirë nga profesionistë të fushës, si dhe do të ndërlidhet më së miri teknologjia dhe arti. Koncepti do të jetë mësimi nëpërmjet prodhimit (Learning by doing). Kështu Piramida do të jetë një mjedis ku do të edukohen dhe trajnohen mbi 2000 të rinj dhe të reja. Nëpërmjet këtij projekti do të aktivizohet një hapësirë prej 9460 m² për të akomoduar funksionet teknologjike dhe edukuese. Për ta realizuar këtë do të ndërhyhet fizikisht në objekt për ta kthyer në një mjedis operativ dhe funksional përsa i përket aspektit teknik.

Ndërhyrja për Rijetësimin e Piramidës ka për qëllim ta bëjë atë një vend ku shkëmbehen ide dhe vizione, një forum publik ku të gjithë janë të mirëpritur të ndajnë dhe të fitojnë njohuri. Larmia e funksioneve dhe ngjarjeve duhet të garantojë që piramida nuk do të flejë kurrë si një objekt që do të jetë i mbushur me aktivitete.

Qëllimi i projektit nuk është të rivendosë ndërtesën në pamjen e saj fillestare, por të hulumtojë gjendjen e saj aktuale, për të gjetur bukurinë dhe për të qenë e vërtetë dhe autentike.

Piramida do të shndërrohet në një aktor vetë-mjaftues në mjedisin urbanistik të Tiranës, do të bëhet një ambient efikas dhe me kosto efektive, do të përdoret vetëm ajo që na nevojitet dhe pjesa tjetër do të kthehet publikut. Projekti është hartuar duke u mbështetur në kushtet teknike shqiptare dhe ato europiane si edhe produkteve që nxjerrin prodhues të ndryshëm europian.

Aksesi

Duke hequr xhamin në të gjitha hyrjet, lidhja me pjesën e jashtme bëhet e menjëhershme. Ndërtesa bashkohet me rrethinat e saj dhe hyrja nuk mund të kufizohet më. Monumenti dikur i frikshëm dhe armiqësor shndërrohet në një hapësirë mikpritëse dhe ftuese.

Fasada

Mbështjella ekzistuese e ndërtesës aktualisht përfshin si elementë prej betoni ashtu edhe xham. Elementet e betonit dhe xhamit janë një seri shiritash radiale të pjerrëta që shtrihen nga niveli i tokës në nivelin e çatisë. Ndërhyrja e propozuar në mbështjellë përfshin zëvendësimin e pjesëve të xhamta ekzistuese me xhama të rinj të hapshëm. Rripi më i gjerë është në hyrje, në perëndim të ndërtesës. Ky rrip shtrihet nga niveli i tokës deri në çatinë e ndërtesës, dhe është në formë trapezoidale. Xhami i ri i hyrjes siç propozohet përfshin një grup pjesësh xhami që rrotullohen rreth një aksi horizontal për të lejuar që xhami të hapet.

Për pjesët e pjerrëta të betonit të gjitha pllakat ekzistuese do të hiqen dhe zëvendësohen me gur të ri natyror prej 20 mm të ngjitur me rrjetë shtesë të me fibra xhami. Do të jenë të ngjashëm si ata ekzistues, mund të jenë gurë lokalë dhe të krahasueshëm me gurët natyrorë

përreth. Pllakat ekzistuese të hequra ripërdoren si material granular për çatinë e betonit të lëmuar dhe shkallët.

Risia e rigjallërimit të qendrës qëndron në faktin se do të zbatohet modeli mësimor TUMO i cili është një lloj i ri i përvojës arsimore në kombinimin e teknologjisë dhe dizajnit. Programi mësimor parashikohet të jetë i përbërë nga aktivitete të mësimi autodidakt, ëorkshope dhe laboratorë projektesh, ku fëmijët e të rinjtë i kombinojnë këto metoda mësimore personale që të përshtaten me preferencat e tyre dhe shkallën individuale të përparimit. Mes këtyre programeve mësimore përfshihen: animacion, zhvillim lojërash dhe filmimesh, ëeb dizajn, muzikë, shkrim, vizatim, dizajn grafik, modelim 3D, programim, robotikë, fotografi, etj. Teksa të rinjtë përparojnë me projektet dhe praktikat ata do të krijojnë një portofol bazuar mbi rezultatet e tyre i cili do të kthehet në një lloj diplome që do të dëshmojë rritjen e aftësive të tyre në fushat përkatëse. Jemi të bindur se investimi në programe të tilla të zhvillimit kreativ tët rinjve do të jetë një nga investimet kryesore me impakt afatgjatë për një shoqëri më të zhvilluar në të ardhmen. Aktualisht janë realizuar rreth 11% e punimeve për realizimin e këtij projekti. Afati i dorëzimit është 2 shkurt 2023.

KOPSHTI ZOOLOGJIK

Në Kopshtin Zoologjik prej rreth 30 vjet nuk investohet dhe si pasojë e kësaj është shndërruar në një kopsht të vjetër dhe pa kushtet minimale për mirëmbajtjen e kafshëve. Si pasojë e terrenit jo cilësor dhe të kushteve jo të mira ka shumë pak kafshë të cilat mbahen të mbyllura në hapësira shumë të vogla dhe larg parametrave dhe standardeve të duhura.

Si pasojë e sa më lart, projekti ynë do të zgjerohet sipërfaqen aktuale dhe do ta shndërrojë kopshtin zoologjik në një park zoologjik të standarteve më të larta. Përvec zgjerimit të sipërfaqeve për kafshë parashikohet krijimi i habitatave në mjedise të hapura sa më të ngjashme dhe sa më afër habitatit natyror. Përvec ndërhyrjeve në mjedise parashikohet shtimi i numrit të kafshëve. Projekti do të ofrojë një park të ri për familjet dhe fëmijët e Tiranës e mbarë Shqipërisë dhe do të jetë gjithashtu një atraksion i ri jo vetëm për kryeqytetasit po për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj.

E gjithë hapësira e kopshtit zoologjik është konceptuar në disa mini zona si më poshtë:

ZONA E HYRJES,

Hapësira parkimi për 72 automjete e zhytur nëntokë 1.50 m,

Hapësira për vizitorët ku përfshihen biletari me 4 sportele, grup shkallë ashensore, pika kontrolli, dyqan suveniresh. bar/restorant

Hapësira rekreacioni dhe pushimi ku përfshihen zona pikniku, hapësira të gjelbërta të lira nga strukturat dhe të veçuara për familjarët e fëmijët, kënde lojërash tper fëmijë ë shpërndara nëpër kopsht

Hapësira edukimi ku përfshihen 2 klasa për 25-30 studentë secila si dhe një auditor me 100-120 vende

Hapësira për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e Kopshtit ku përfshihen zyra për administratën, zyrë sigurimi dhe monitorimi, sallë mbledhjesh etj

Hapësira për përgatitjen e ushqimit për kafshët

Hapësira për mirëmbajtjen, kontrollin e menaxhimin e kafshëve
Veterinaria

Projekti parashikon tharjen e liqeneve ekzistuese dhe krijimin e tre liqeneve të reja me thellësi max 2m, duke aplikuar materialet e reja si gjeomembrana Macline, të veshura me pllaka betoni. Pjesa e hyrjes mbulohet nga një strukturë e vetme druri e cila hijezon, unifikon e fsheh pjesën e ndërtuar. Gjithashtu projekti parashikon edhe zonimin e kafshëve për të cilin,

nga zvogëlimi i sipërfaqes ujore përftohet rritje e sipërfaqes për strehimet e kafshëve, të realizuara të diferencuara sipas kërkesave të secilit lloj. Përsa i përket gjelbërimit konsiston në tre nivele sipërfaqe të mbjella me bar, shkurret dhe pemët e larta të shpërndara në mënyrë të tillë për t'ju përqasur natyrës së egër, pa cënuar sigurinë dhe qetësinë e njerëzve. Aktualisht jemi në fazë përfundimi. Parashikohet që punimet për realizimin e objektit të përfundojnë në dhjetor të këtij viti.

TEATRI KOMBËTAR

Kryeqyteti ka nevojë për një godinë të re të Teatrit Kombëtar që plotëson të gjitha standartet ndryshe nga ai ekzistues. Shtëpia e re e aktrimit është konceptuar të jetë si zemra kulturore e Tiranës dhe e gjithë Shqipërisë dhe e dedikuar vetëm për art. Projekti i prezantuar nga një nga studiot më të mëdha ndërkombëtare të arkitekturës në botë, “Bjarke Ingels Grop” me qendër në Danimarkë, ofron një godinë të arkitekturës me dizajn modern dhe që krijon një hapësirë unike në qytetin e Tiranës, duke ofruar të gjitha kushtet e nevojshme dhe frymëzuese për zhvillimin e talentit të aktrimit, ashtu edhe për vetë publikun i cili mund të angazhojë imagjinatën.

Projekti gjithashtu garanton një akses të këmbësorëve që përdorin rrugën “Sermedin Said Toptani” në rrugën paralele me të. Hyrja kryesore në teatër është e mundur përmes shëtitores “Murat Toptani”, ndërsa hapësira e sheshit publik në nivelin përdhes, siguron hyrje të mbuluar në teatër, së bashku me hapësirën publike për mbledhje ose argëtim. Me ndërtimin e teatrit të ri aktorët do kenë mundësi të punojnë në ambiente kontemporane, cilësore dhe jo të dëmshme për shëndetin e tyre. Njëkohësisht edhe qytetarët do të kenë mundësi të shijojnë artin e ofruar nga artistët në ambiente të rehatshme me të gjitha kushtet që meriton të ketë një godinë e tillë.

KAMPUSI UNIVERSITAR

Ne e konsiderojmë investimin në kapitalin njerëzor si një nga elementët më të rëndësishëm që garanton zhvillimin ekonomik. Ndërtimi i kampuseve të reja për Universitetin e Tiranë që është njëkohësisht dhe universiteti më i rëndësishëm në vend është sot një domosdoshmëri. Për këtë arsye do të bashkërendojmë punën me qeverinë për ndërtimin e kampuseve si dhe për ndërtimin e të parës Qendër të Studentëve në vendin tonë. Këto projekte jo vetëm që do të krijojnë kushte më cilësore për studentët, por do t'i japin Tiranës fytyrën e një qyteti studentor bashkëkohor.

Ndërtimi i Kampusit të konsoliduar të Universitetit të Tiranës synon shndërrimin në një hapësirë moderne të një prej zonave më energjike dhe më të rëndësishme të kryeqytetit. Ndërtimi i objekteve të reja universitare në zonën e Qytetit Studenti, integrimi i tyre me objektet ekzistuese si dhe me objektet e tjera akademike rreth tij, do të ofrojë mjedise të bollshme e moderne për universitetin çka do të rrisë jo vetëm cilësinë akademike, por edhe cilësinë e jetesës për të gjithë studentët e Universitetit të Tiranës.

Ndërkohë që Qendra e Studentëve do të jetë një qendër multifunkionale që do të ofrojë një shumëllojshmëri shërbimesh për të gjithë studentët e Tiranës. Aty do të kombinohen aktivitetet akademike me ato sociale e kulturore, të gjitha të organizuara nga vetë studentët dhe në shërbim të studentëve. Në këtë qendër do të ketë salla leximi, laboratorë kompjuterik, zyra të ndryshme që ofrojnë shërbime për studentët, mjedise çlodhëse, salla lojërash, si edhe mjedise ku mund të organizohen aktivitete të ndryshme, konferenca e ekspozita artistike. Të gjitha hapësirat e reja të kampusit universitar, si ato të brendshme dhe ato të jashtme do të

konceptohen dhe shfrytëzohen si hapësira multifunkionale moderne dhe sipas standarteve duke ushqyer një jetë studentore sa më të pasur, aktive dhe të shëndetshme që rrit mirëqenien e studentëve dhe si rrjedhim performancën e tyre në mësim dhe jetë sociale.

TIRANA POLICENTRIKE

Koncepti i vjetër i zgjerimit dhe zhvillimit urban të Tiranës synonte që kryeqyteti të zhvillohej në mënyrë Monocentrike ku cdo shërbim, funksion kryesor dhe aktivitet parësor zhvillohej në qendër të qytetit. Kjo mund të ketë funksionuar mirë në të kaluarën, por me zhvillimin urban të tanishëm të Tiranës, rritjen e popullsisë dhe për rrjedhim zgjerimin e territorit sjell trafik të rënduar, pabarazi në zhvillimin ekonomik mes zonave qendrore dhe atyre periferike të qytetit, stres urban, ndotje ajri, etj.

Jemi duke zhvilluar Organizimin e Tiranës në disa qendra kryesore dhe dytësore të cilat do të ndihmojnë në procesin e dendësimit me anë të përdorimit të zgjuar të tokës dhe shpërndarjes së funksioneve dhe shërbimeve të njëjta në gjithë territorin. Ky prioritet ka në qendër krijimin e 5 epiqendrave urbane për kapërcimin e dyzimit qendër-periferi dhe për të nxitur zhvillimin e balancuar të qytetit. Kinostudio, Kombinati, Farkë-Qytet Studenti, Bulevardi i Ri dhe Lapraka janë polet e parashikuara për t'u zhvilluar nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të Planeve të Detajuara Vendore që do të sigurojnë rivitalizimin dhe forcimin e identiteveve sipas karakterit të çdo poli. Përmbushja e këtij objekti do të jetë një nga sfidat kryesore të 4-vjecarit të ardhshëm por që në fund do të sjellë një rikonceptim të strukturës urbane të qytetit, shtimin e pesë zonave atraktive të reja për qytetarët dhe vizitorët e huaj dhe një rritje me rreth 20% të investimeve në këto pole të reja. Polet për të cilat po punohet sot janë:

Poli Verior- Bulevardi i Ri i Tiranës Ka përfunduar dhe segmenti i fundit i zgjatimit të bulevardit me sinjalistikë rrugore, korsi të dedikuara autobuzësh dhe bicikletash, ndriçim led dhe gjelbërim. Tashmë do të nisë puna për realizimin e sheshit fundor dhe gjatë 4-vjecarit në vazhdim kjo zonë do të ketë një karakter Fin-Tech, pra do të jetë zona e financave dhe e teknologjisë për qytetin. Gjithashtu, gjatë lumit të Tiranës do të mbizotërojnë korridoret blu dhe të gjelbër me hapësira shlodhëse e rekreative, korsi bicikletash në natyrë të cilat do të promovojnë jetesën e balancuar dhe të shëndetshme në qytet.

Poli Kombinat - Sot po punohet për rivitalizimin e Sheshit Garibaldi dhe godinave të vjetra përreth, ndërkohë që janë bërë shumë investime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ndricimit të zonës. Vizioni dhe objektivat tona për 4-vjecarin e ardhshëm synojnë kthimin e Kombinatit në një zonë urbane me karakter kreativ artistik dhe mjeshtëror i cili sjell më shumë mundësi biznesi dhe do të zbatohet modeli i Pazarit të Ri.

Poli Farkë – Qyteti Studenti Deri më tani zona përreth Liqenit të Farkës ka patur një sërë investimesh për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ndricimit, gjelbërimit përreth Liqenit dhe vendosjen e korsive të bicikletave dhe lojërave ujore. Këto investime dhe të tjera në vazhdim do ta kthejnë polin e Farkës në një zonë me karakter rekreativ, natyror dhe turistik e cila do të gezojë investime dhe vëmendje njëjloj si Parku i madh i Liqenit të Tiranës duke shtuar hapësirat e gjelbra për ushqimin e jetës kolektive si edhe hapësira për aktivitete sportive. Gjithashtu do të ketë investime dhe shërbime si shkolla, kopshte e cerdhe, biblioteka në zonën e Farkës dhe lidhjen e saj me qytetin studentit.

Poli Kinostudio dhe Poli Laprakë janë 2 polet e tjera për të cilat po punohet për hartimin e planeve të detajuara vendore. Për to kemi parashikuar gjithashtu një sërë investimesh infrastrukturore në qendrat dhe pikat referuese të zonave të cilat do të kthehen në pole të mirëfillta zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i jetës sociale e rekreative për komunitetin duke ngushtuar hendekun dhe diferencat mes tyre dhe qendrës së qytetit. Për Polin Kinostudio

kanë filluar punimet për përmirësimin e infrastrukturës së qendrës së polit dhe infrastrukturës rrugore, ndricimit dhe gjelbërimit përreth. Ndërkohë që Poli Laprakë është në fazë projektimi.

ZGJERIMI I LUMIT LANA

Zgjerimi i lumit Lana është një projekt me rëndësi të lartë për Tiranën. Puna për zgjerimin e Lanës po vazhdon dhe Lana do të zgjatet nga Kashari deri në Shkozë. Duke vazhduar nga Lanabrgas e poshtë deri në Kashar. Duke u zgjeruar kështu 2 km në Veri e 2 km në Jug. Disiplinimi i ujrave të një lumi në territore urbane tashmë të zhvilluara, është shumë i rëndësishëm dhe ka një impakt shumë pozitiv në mjedis e komunitet. Përmes kësaj veprë madhore, qyteti do të fitojë shumë përmes disiplinimit të rrjedhës së lumit të Lanës duke ulur rrezikun e përmbytjeve, por edhe për krijimin e një ambienti pozitiv. Prania e një lumi për një qytet është shumë e rëndësishme. Disiplinimi i ujrave sjell transformimin e hapësirave publike, duke i transformuar ato në vlera për lagjen duke qenë se Lana ka qënë historikisht një shenjë e rëndësishme në territorin e qytetit dhe ka dhënë drejtimet për zhvillimin e tij.

UNAZAT E TIRANËS

Përmirësimi i situatës së trafikut në Tiranë është një nga sfidat tona më të mëdha me të cilat kemi punuar këto 4 vite dhe do vijojmë të punojmë edhe më fort gjatë 4-vjecarit të ardhshëm. Përfundimi i Unazës së Madhe të Tiranës (Unaza 5-stë) përbën një hap të rëndësishëm drejt lehtësimit të trafikut duke qenë se shërben si bypass për transportin e mallrave larg zonës urbane. Unazat i shërbejnë mirëfunksionimit të lëvizjes duke larguar shumicën e trafikut nga zemra e qytetit. Njëkohësisht ato shkurtojnë kohën e lëvizjes duke rritur shpejtësinë dhe ulur koston e udhëtimit. Në planin tonë të lëvizshmërisë së qendrushme për të cilën sapo kemi filluar punën, unazat do të shërbejnë si shtylla të zhvillimit duke siguruar akses në të gjitha zonat e Tiranës.

Unaza e Madhe e Tiranës përfshin në gjatësinë e saj ura, nyje dhe kryqëzime në nivel me qëllim lehtësimin e impaktit që kjo vepër e madhe infrastrukturore do të ketë në qytet.

Sot kemi hapur një nga segmentet kryesore të Unazës së Madhe me një gjatësi prej 2.1 km, që lidh zonën e “Pallatit me Shigjeta” me Farkën, duke zgjidhur problemin e trafikut të makinave që vijnë nga sheshi “Shqiponja” dhe Kombinati në drejtim të qendrës, si dhe të atyre që udhëtojnë drejt juglindjes. Segmenti Komuna e Parisit-Shkolla Teknologjike është përshtatur për zona urbane me rrugë kryesore, rrugë paralele dhe e konceptuar si rrugë shpejtësie me 12 hyrje-dalje të disiplinuar. Për të lehtësuar qarkullimin e automjeteve dhe për të rritur sigurinë e qytetarëve, janë ndërtuar dhe katër mbikalime automjetesh në disnivel, mbikalime këmbësorësh të pajisura dhe me ashensor për Personat me Aftesi te Kufizuar (PAK), si dhe në të dy senset e lëvizjes janë ndërtuar trotuarë dhe korsi biçikletash. Punimet e kryera me standardet më të mira europiane përfshijnë ndërtimin e plotë të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, vendosjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, instalimin e plotë të ndriçimit rrugor si dhe shtimin e gjelbërimit.

Mirëfunksionimi i Unazës së Vogël të Tiranës, Unazës së Ndërmjetme dhe Unazës së Madhe do të çlirojnë qendrën e Tiranës nga trafiku duke e ndryshuar destinacionin e një pjese të rrugëve në hapësira pedonale dhe të lëvizjes me biçikletë.

Unazat do të rrisin cilësinë e lëvizjes, por edhe rëndësinë e Tiranës si një qytet ndërlidhës për të gjithë rajonin duke lejuar kalimin e natyrshëm nga akset lindore në ato veriore e perëndimore dhe duke larguar trafikun e tranzitit ndërrurban nga qendra e qytetit.

Përfundimi i segmentit jug-perëndimor së Unazës së Madhe me të cilin angazhohemi për 4 vitet e ardhshme, do të ndihmojë në mirë-menaxhimin e trafikut tranzit e të gjithë rajonit lindor në drejtim të aeroportit Nënë Tereza si edhe portin e Durrësit. Ky investim siguron jo vetëm me pak kohë të humbur në trafik por edhe përmirësimin e cilësisë së ajrit i cili impaktohet në mënyrë direkte nga trafiku i rënduar. Realizimi në të ardhmen i segmentit verior do të marrë një rëndësi të vecantë sepse do të shërbejë gjithashtu si një portë hyrëse në qytet dhe do të ndërlidhet me rrugën e Arbrit.

ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK- TEDA KASHAR (Technological Economic Development Area)

Po punohet për krijimin e një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në të cilën Bashkia do të ketë rolin e zhvilluesit të kësaj zone duke përmbushur kriteret e legjislacionit në fuqi. Projekti “TEDA Kashar” parashikon realizimin e një investimi me vlerë totale prej € 102,666,431, të ndarë sipas fazave dhe hapjen e 5.000-7.000 vende pune. Projekti synon të shtrihet në një sipërfaqe prej 35 ha në njësinë administrative Kashar, Bashkia Tiranë.

Ky projekt strategjik, synon të zgjerojë gamën e industrive operuese në treg, duke krijuar diversifikim për të tërhequr industri prodhuese komplekse siç janë: Industria automobile, ICT dhe Industria e pajisjeve elektronike. “TEDA Kashar” do jetë projekti i parë i mirëfilltë i cili inicion procesin e krijimit të Klasterave ekonomike sipas skemave më të suksesshme në rajon dhe Europë.

Komisioni i Investimeve Strategjike (KIS) duke parë potencialin e këtij investimi të rëndësishëm me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, me anë të Vendimit Nr. 1/8, datë 15.05.2020, i dha statusin e “Projekt me Potencial Strategjik Zona Teknologjike dhe e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Kashar”. Ky Vendim i rëndësishëm i hapi rrugë vijimit të mëtejshëm të procesit për përfitimin e Statusit përfundimtar “Investim/Investitor Strategjik” si dhe të statusit “Zonë Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik”, status ky që iu dha Bashkisë Tiranë nga KIS me Vendimin nr 1/8 datë 15.07.2021. Në këtë kuadër, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me kompaninë konsulente si dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces (AIDA, OST, OSHEE, UKT, ARRSH etj.), po punon për hartimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Planit të Biznesit si dhe dokumentave të tjera të nevojshëm për aplikim. Pas përfitimit të Statusit “Investim/Investitor Strategjik” dhe “ZTZHE Kashar” përgjatë vitit 2022, Bashkia e Tiranës parashikon zbatimin e këtij projekti duke filluar me ndërtimin e infrastrukturës përkatëse, krijimin e paketës së plotë ligjore dhe incentivuese si dhe të një strategjie marketingu për thithjen e investimeve dhe ngritjen e industrive e bizneseve me teknologji të avancuar dhe potencial të lartë ekonomik.

RINDËRTIMI

Viti 2021 ka qenë përsëri një sfidë për Bashkinë e Tiranës si rrjedhojë e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 si dhe Pandemisë COVID-2019, situatë e cila ka sjellë të nevojshme riorientimin e objektivave strategjike. Në fund të vitit 2019 nisën programet e rindërtimit, fillimisht me subvencionimin e qerasë për familjet e prekura nga tërmeti, dhe më tej në vitin 2020, me akordimin e fondeve buxhetore nga Qeveria, për programet e tjera si, për rindërtimin e banesave individuale, për ndërtimin e infrastrukturës arsimore, publike, ndërtimin e njësive të banimit, akt-ekspertiza, plane të detajuara vendore, grante rikonstruksioni. Programet e rindërtimit të nisur në vitin 2020 do të vijojnë edhe gjatë vitit 2022 dhe do të ndihmojnë rimëkëmbjen ekonomike në vitet pasardhëse.

Gjatë vitit 2021, nëpërmjet financimit nga fondet buxhetore akoluar nga Qeveria për Bashkinë Tiranë, ka vazhduar procesi për programet e rindërtimit, të cilat përveçse do t'i japin zgjidhje strehimit të banorëve të prekur nga tërmeti, do të ndikojnë në rimëkëmbjen ekonomike të qytetit.

Konkretisht:

Në programet e Arsimit, Bashkia e Tiranës nëpërmjet fondeve të akorduara të rindërtimit ka vazhduar procesin për angazhimin për ndërtimin e 12 shkollave dhe kopshteve të dëmtuara rëndë nga tërmeti i datës 26.11.2019 si psh “Ndërtim i shkollës “Sami Frashëri”, “Ndërtim i shkollës 9-vjecare “Qazim Turdiu”, “Ndërtim i shkollës 9-vjecare “17 Shkurti”, Qesarakë e Vjetër, Ndërtim shkolle dhe godinë për shërbime komunitare – Vaqarr, Ndërtim kopësht & çerdhe dhe qendër shëndetësore – Ndroq etj.

Në programet e zhvillimit dhe Shërbimet publike vendore, Bashkia e Tiranës nëpërmjet fondeve të akorduara të rindërtimit ka vazhduar procesin për angazhimin e ndermarre për ndërtimin jo vetëm të infrastrukturës publike por dhe të njësive të banimit(pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim në Njësitë Administrative 4 dhe 8, Zona “5 Maji” dhe Njësinë Administrative 6 Zona “Kombinat” si dhe ndërtimi për zonat e reja psh “Ndërtim i infrastrukturës publike në zonën e Baldushkut”, “Ndërtim i infrastrukturës publike në zonën e Ndroqit”, etj.

Në programet e Kujdesi Social dhe Strehimit lokal dhe Urbanistikës, Bashkia e Tiranës nëpërmjet fondeve të akorduara të rindërtimit ka marrë angazhimin për ndërtimin jo vetëm të banesave individuale por dhe të Hartimit të Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për zonat e reja për rrizhvimin për strehim si dhe granteve të rikonstruksionit që ju akordohen cash qytetarëve, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti.

Projektet e reja të planifikuara në PBA 2022 – 2024, sipas programeve, synojnë:

Programi i Transportit

Përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit rrugor, rritjen e aksesit të përdorimit të transportit publik e bicikletave, si dhe rritjen e kushteve të sigurisë për të gjithë përdoruesit e rrugës. Kjo do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të rrugëve të reja dhe rehabilitimit të atyre ekzistuese si në qytet dhe në zonat rurale (“Rikonstruksioni i rrugës "Agallarëve", NjA Farke”; “Rikualifikim i bllokut “Lord Bajron - Riza Cuka - Pandi Dardha – Dritan Hoxha” NjA 11; “Rruga për tek Liqeni Cerkezës”, NjA Zall Herr; Ndërtimi i rrugëve të fshatit Gurrë e Vogël, Petrelë), shtimin e rrjetit të korsive të bicikletave (Studimi dhe projektimi i elementeve të sigurisë rrugore për rrjetin ekzistues të korsive të bicikletave, përmirësimin, shtimin dhe kompletimin e tyre); ndërtimi i urave që lidhin fshatrat me qendrat administrative ose rrugët kryesore (ura Bonarakëve, Bërzhitë; ura në lagjen Fezaj, Zall Bastar), sinjalistikës rrugore (horizontale dhe vertikale); Aplikimin e sistemeve të reja IT (GPS, biletimi elektronik) në transportin publik; Përmirësimin e cilësisë së shërbimit në transportin publik (Ndërtimi i korsive të dedikuara për autobus në disa akse rrugore, zgjidhja e nyjes së Paskuqanit dhe rehabilitimi i stacioneve të autobusëve në zonën qendrore të Tiranës); Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësive vendore; Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private; Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit.

Programi i Shërbimeve Publike Vendore

Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit e strukturave, rekreativ, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin (“Rehabilitim i qendrës Kinostudio”, NjA 4; Rikualifikimi i territorit që kufizohet nga Rr. “Dibrës – 5 Maji – Ferit Xhajko – Gjon Buzuku”, NjA 8; “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rrugët 3 Dëshmorët – Rexhep Shala – Joklin Persi, Lagjia 14); shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; ndërtimi dhe rehabilitimi i trotuareve me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve (“Ndërtimi i trotuareve rruga Myslym Shyri”, NjA 7+10). Ndërtimi i hapësirave për parkim publik (“Rehabilitimi i fasadave & rrugës Luigj Gurakuqi deri tek Sheshi “Avni Rustemi dhe parkim 2 kate nën tokë”, NjA 2). Ndërtimi dhe rehabilitimi i ndricimit publik (“Përmirësimi i ndricimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të bicikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri tek hyrja e liqenit Artificial”, NjA 2+5). Shtimi i sipërfaqeve të varrezave publike (Tufinë dhe Sharrë), si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;

Programi i Arsimit Bazë dhe Parashkollor

Edukimin e fëmijëve me rregullat e lëvizjes në rrugë dhe përdorimin e bicikletës, si mjet lëvizjeje dhe rekreativ (Projektimi i shkollës së bicikletave, për grupmoshat 7 – 10 vjec).

KAPITULLI III
PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2022-2024

III. 1. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË VETA BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIUdhËN 2022-2024

Për vitin 2022 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë parashikuar në vlerën e 14,407,253,000 lekë. Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të të ardhurave për vitet 2022 - 2024, mund të shihet në tabelën më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plan 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Të ardhura të taksueshme	9,748,398,000	9,721,200,000	9,754,260,000	9,783,812,000
Të ardhura jo tatimore	4,467,038,000	4,686,053,000	4,770,670,000	4,852,416,000
Total të ardhura	14,215,436,000	14,407,253,000	14,524,930,000	14,636,228,000
Transferta e pakushtezuar e përgjithshme	2,438,116,570	2,523,450,650	2,550,000,000	2,600,000,000
Transferta e pakushtezuar sektoriale	2,331,955,992	1,269,437,150	1,300,000,000	1,350,000,000
Total Transferta	4,770,072,562	3,792,887,800	3,850,000,000	3,950,000,000
Të ardhura të mbartura	4,225,588,463	5,400,000,000	2,500,000,000	2,000,000,000
Totali	23,211,097,025	23,600,140,800	20,874,930,000	20,586,228,000

Bazuar në legjislacionin rregullator dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, pjesë e paketës fiskale të Bashkisë Tiranë, janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse për mbledhjen e tyre, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
 - Tirana Parking;
 - Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
 - Agjentët tatimorë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, e cila administron plotësisht procesin e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave vendore për kategorinë e bizneseve, si dhe arkëton dhe ndjek procesin e rakordimit për të ardhurat që mblidhen nga struktura të tjera të Bashkisë dhe nga Agjentët Tatimorë.
- Tirana Parking, është struktura e specializuar vetëm për mbledhjen e tarifës së parkimit sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2016 “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”.
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në administrimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre, arkëtimi i të cilave bëhet me tej nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:
 - Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
 - DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
 - Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
 - Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;

Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2022, paraqiten me një rritje prej 1% krahasuar me planin fillestar të vitit 2021. Në këtë parashikim ndikojnë disa elementë si më poshtë:

- Së pari, në planifikimet për 2022-2024 nuk përfshihen më të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Gjatë vitit 2020 me anë të ligjit 106/2020 “Për disa ndryshime në ligjin 8438 datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, shkalla e tatimit mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 milionë leke do të jetë 0 lekë duke filluar nga data 1 janar 2021.
- Së dyti, të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat Personale (TAP), për vitin 2022 parashikohen me ulje, për arsye të përcaktimit të mënyrës së shpërndarjes ndërmjet njësive vendore në bazë të popullsisë, ndryshe nga parashikimet e mëparshme, sikurse shpjegohet më në detaje në kapitullin përkatës në vijim. Gjithashtu në vitin 2021 ishin parashikuar të arkëtoheshin edhe vitet 2018 dhe 2019, por ky parashikim nuk është bërë ende në buxhetin e shtetit. Efekti financiar është 313.000.000 lekë.
- Së treti, në parashikimet për taksat dhe tarifën e tjera vendore, është marrë parasysh efekti afatmesëm i ndikimit të pandemisë duke pritur që ulja e konsumit dhe ndryshimi i stilit të jetës në një sërë aspektesh do të japë efektin e shtrirë në kohë në veprimtari të caktuara ekonomike, duke mos lejuar rritjen potenciale në kushte normale.
- Se fundi, në parashikimin e vitit 2022, vërehet një rritje e të ardhurave të trashëgueshme nga viti 2021. Ky fenomen është ndikuar specifikisht gjatë vitit 2021, për shkak të realizimit me tejkalim të të ardhurave të parashikuara, të cilat deri në 10 mujin e parë, shënojnë një realizim prej 109% dhe pritshmëria deri në fund të vitit, vlerësohet në 118%. Gjithashtu ka patur një ndikim edhe fokusi gjatë këtij viti tek Programet e Rindërtimit, i cili për Tiranën zbatohet tërësisht nga Bashkia Tiranë. Nga ana tjetër nga ajo që vërehet në trendin e viteve të fundit, pjesërisht për shkak të tejkalimit në realizimin nga disa taksa vendore, kryesisht TNI, dhe pjesërisht prej rritjes së arkëtimeve gjatë dy muajve të fundit të vitit, zëri “Fonde të mbartura” është shtrirë për të gjithë periudhën e PBA-së, për të reflektuar një parashikim më realist të pritshmërive tre vjecare.

Për sa më sipër të ardhurat për vitin 2022 paraqiten me një rritje prej 191,817,486 lekë ose 1% më shumë, krahasuar me parashikimet fillestare tek vitet e mëparshme. Vetëm efekti i munguar i dy taksave të sipërpërmendura, TAP dhe Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, është 489.000.00 lekë, nëse këto dy taksa do vazhdonin të ishin të njëjta, plani do kishte një rritje me 3%. Taksat e tjera janë parashikuar përgjithësisht me një rritje të lehtë, duke konsideruar efektet afatmesme të pandemisë, me përjashtim të pak rasteve që nuk janë ndikuar prej saj, si TNI, etj.

Në mënyrë të detajuar parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifën vendore të Bashkisë Tiranë, për periudhën 2022-2024, paraqitet si më poshtë:

TAKSA VENDORE

A) Taksa mbi ndërtesën

Taksa mbi ndërtesën është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe përbën rreth 14 % të totalit të të ardhurave të veta.

Llogaritja e taksës për ndërtesën/njësi pronësore bazohet në shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, më specifikisht sipas pikes 5, te nenit 2, te VKM 132/2018, te ndryshuar, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për këtë qëllim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera qendrore si, OSHEE, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, etj. kanë patur detyrimin e ngritjes së bazës së të dhënave, krijimin e Kadastrës Fiskale, si informacioni bazë i domosdoshëm për përlogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesën.

Për Bashkinë e Tiranës, struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për këtë taksë nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Tiranë, është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjarë, është përzgjedhur si Agjent tatimor Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a, me vendim të Këshillit Bashkiak dhe rregulluar sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 25505 datë 21.06.2019.

Nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë ka aplikuar taksën mbi ndërtesën sipas ndryshimeve ligjore, për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për aktivitet ekonomik që prej hyrjes në fuqi të ligjit.

Gjatë vitit 2020, kjo taksë ka pasur një ulje në krahasim me vitet e mëparshme, për kategorinë biznese. Sikurse mund të kuptohet, viti 2020 ka pësuar ulje në realizimin e kësaj taksë për shkak të problematikave dhe vështirësive ekonomike që kanë përballuar bizneset gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 si dhe marrjes së vendimit për uljen e detyrimit për sektorin hotelier në masën 30% për detyrimin vjetor të kësaj takse. Ndërsa realizimi i pritshëm i vitit 2021 pritet të jetë më i larti krahasuar me vitet e mëparshme.

Më poshtë paraqitet realizimi në vite i taksës mbi ndërtesën për kategorinë e subjekteve të biznesit:

	në lekë					
Taksa mbi ndërtesën	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Biznesi	1,356,525,315	1,457,892,780	1,586,349,438	1,605,209,838	1,380,326,027	1,650,323,381



Për sa i përket kategorisë së ndërtesave që shfrytëzohen për banim, për shkak të mangësive thelbësore në databazën e Kadastrës Fiskale, që e bënin të pamundur implementimin e taksës mbi bazë të vlerës, Bashkia e Tiranës ka angazhuar agjentin tatimor për të krijuar bazën e të dhënave, në përputhje me rradhën e prioriteteve të përcaktuara në Vendimin nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”. Agjenti Tatimor, me anën e strukturës së posaçme për përmbushjen e këtij detyrimi, ka marrë masa për plotësimin e bazës së të dhënave për faturimin, duke u bazuar fillimisht në vetëdeklarimet e qytetarëve pranë zyrave të agjentit tatimor.

Për familjet që nuk kanë kryerë vetdeklarimin faturimi është kryer në bazë të hapave të parashikuar në Vendimin nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” të ndryshuar.

Ky proces është vështirësuar gjatë këtyre viteve nga pamundësia e aksesit në banesat e qytetarëve për kryerjen e matjeve në terren të sipërfaqeve të banueshme.

Pavarësisht kësaj siç mund të shihet aplikimi i formulës së re ka dhënë efekt në realizmin e tarifës së pastrimit për kategorinë “Familjarë” të pasqyruar si më poshtë:

n
ë lekë

Taksa mbi ndërtesën	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Familjarë	116,857,519	216,542,796	228,647,177	233,353,993	536,606,757	667,166,963



Planifikimi i të ardhurave për periudhën 2022 – 2024 merr në konsideratë ndryshimet ligjore për këtë taksë. Planifikimi për kategorinë e bizneseve është bërë në bazë të të dhënave të DPTTV, ndërsa për kategorinë familjare në bazë të një vlerësimi paraprak, sipas të dhënave aktuale që disponohen nga baza e të dhënave e krijuar nga Agjenti Tatimor.

Në vitin 2022, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën janë parashikuar në vlerën 2,640,000,000 lekë.

Ky parashikim ka marrë parasysh ndikimin gjatë vitit 2021 dhe, që do të ketë gjatë fillimit të vitit 2022, situata e krijuar nga pandemia Covid-19 për të dyja kategoritë në formën e mbylljes së bizneseve dhe në pamundësinë e marrjes së informacionit për ndërtesat e familjarëve si pasojë e masave në kuadër të distancimit social.

Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjarë dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

në lekë				
Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,612,560,000	2,640,000,000	2,659,700,000	2,679,597,000
- Familjarët	658,560,000	670,000,000	670,000,000	670,000,000
- Subjektet Tregtare	1,954,000,000	1,970,000,000	1,989,700,000	2,009,597,000


B) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit më parë të vlerës sipas përcaktimeve ligjore.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paraqitet në rritje në krahasim me realizimi e vitit 2020. Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë tejkalon planin e miratuar si rrjedhojë e aplikimeve përtej parashikimeve.

Ndryshe nga cdo fushë tjetër e aktivitetit tregtar, sektori i ndërtimit ka vazhduar të jetë një prej shtyllave bazë të zhvillimit ekonomik dhe njëri prej aktiviteteve që sjell më shumë të ardhura. Vlen të theksohet që ky sektor nuk është ndikuar sikundër sektorët e tjerë nga masat kufizuese të pandemisë.



Në bazë vjetore, volumi i ndërtimit nuk ka ndryshime të theksuara nga periudha përpara vitit 2017, c’ka do të thotë që rritja në nivelin e arkëtimeve ka ardhur si rezultat i ndryshimit të bazës së taksueshme. Suksesi i mbledhjes së kësaj takse si në vitin 2018, 2019 dhe në vitin 2020, duke patur parasysh se cmimet në qytetin e Tiranës nuk janë rritur por rezultojnë krahasueshmërisht të njëjta tregon se kjo taksë nuk ka patur asnjë impakt tek qytetari, por ka ulur deri diku fitimin e zhvilluesve, por jo aq sa të disincentivojë apo ulë interesin e tyre për zhvillim. Pra është arritur një balancë midis “vullnetit për të paguar” të biznesit të ndërtimit dhe volumit të ndërtimit që krijon hapësirë rezidenciale për dhjetra mijëra rezidentët e rinj që i shtohen çdo vit Tiranës.

Referuar vlerësimeve të drejtorisë përgjegjëse pritet që ecuria e arkëtimit të jetë nën nivelin e viteve të fundit. Kjo për arsye se të ardhurat nga kjo taksë parashikohet të mbështeten kryesisht në zhvillimet e reja që pritet ti shtohen Tiranës në zonën e mirëplanifikuar të Bulevardit të Ri, ku është miratuar edhe Plani i Detajuar Vendor nga Këshilli Kombëtar i Territorit – plan ky që i hap rrugë zhvillimit.

Konkretisht për vitin 2022 dhe në vijim 2023 dhe 2024, parashikimet për këtë taksë, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,800,000,000	4,800,000,000	4,800,000,000	4,800,000,000

C) Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitete ekonomike në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa detyrimi nga kategoria familjarë arkëtohet nga agjenti tatimor i përzgjedhur për këtë qëllim, Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore ka një realizueshmëri të kënaqshme që nga koha e hyrjes në fuqi, në vitin 2016, si për kategorinë biznese edhe për kategorinë familjarë. Gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje të dukshme në krahasim me vitet e mëparshme.

Të dhënat e ecurisë paraqiten në tabelën më poshtë:

Lloji i të ardhurave	në lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore	495,950,390	681,927,166	730,095,161	699,773,149	649,392,794	773,830,278
Familjarët	141,429,000	266,244,300	286,498,987	274,551,161	288,293,159	319,018,389
Subjektet Tregtare	354,521,390	415,682,866	443,596,174	425,221,988	361,099,635	454,811,889



Për periudhën 2022 – 2024, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:

Lloji i të ardhurave	në lekë			
	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore	754,000,000	810,000,000	814,900,000	819,849,000
Familjarët	314,000,000	320,000,000	320,000,000	320,000,000
Subjektet Tregtare	440,000,000	490,000,000	494,900,000	499,849,000

Në paketën fiskale të vitit 2020 u diferencua kategoria biznes i vogël me xhiro 0-2 milionë lekë, për të lehtësuar barrën fiskale të kësaj kategorie dhe kjo ka impaktuar parashikimet për periudhat në vijim nga kjo taksë.

D) Taksa e tabelës

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesioneve të lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

- I. Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo brenda territori ku zhvillon veprimtarinë e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe ose aktiviteti i biznesit:
 - ✓ Tabelë deri në 2 m²;
 - ✓ Tabelë mbi 2 m² deri në 10 m²;
 - e thjeshtë (pa ndricim)
 - me ndricim të thjeshtë;
 - elektronike.
 - ✓ Tabelë mbi 10 m² deri në 20 m²;
 - e thjeshtë (pa ndricim)
 - me ndricim të thjeshtë;
 - elektronike.
 - ✓ Tabelë mbi 20 m² deri në 40 m²;
 - e thjeshtë (pa ndricim)
 - me ndricim të thjeshtë
 - elektronike
 - ✓ Tabelë mbi 20 m² deri në 40 m²;
 - e thjeshtë (pa ndricim)
 - me ndricim të thjeshtë
 - elektronike
- II. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelës për orientim.
- III. Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në tavanin 35 m²:
 - ✓ Tabelë e thjeshtë me/pa ndricim;
 - ✓ Tabelë elektronike.
- IV. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. (të të gjitha përmasave)

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite është përgjithësisht e qëndrueshme edhe pse arkëtimet nga kjo taksë varen nga përdorimi i tabelave reklamuese nga ana e bizneseve, i cili është i ndryshueshëm në varësi të zgjedhjes së biznesit për të reklamuar ose jo në një vit të caktuar, ndërkohë që për tabelën për qëllime identifikimi, deri në 2 m² masa e taksës është zero.

Realizimi në vite pasqyrohet në tabelën më poshtë:

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Taksa e tabelës dhe reklamës	309,949,842	345,930,032	307,879,375	268,203,139	236,214,879	277,616,353



Referuar realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2021, nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, si dhe vlerësimeve paraprake mbi përdorimin e tabelave reklamuese, parashikimi i të ardhurave për vitet 2022 – 2024, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa e tabelës	300,200,000	300,200,000	303,250,000	306,330,000
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	200,000	200,000	250,000	300,000
Tabelë reklamuese	300,000,000	300,000,000	303,000,000	306,030,000

E) Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Subjekte hoteleri me 4–5 yje me nivel takse për 350 lekë/dhoma;
- Subjekte hotele, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin në nivel takse për 140 lekë/dhoma

Gjatë vitit 2020 sektori i hotelerisë ishte një nga sektorët më të prekur për shkak të pandemisë Covid – 19 dhe në bazë të raportimeve nga DPTTV, edhe pse filloi të ndryshonte gjatë vitit 2021 efekti i pandemisë vazhdon të ketë impakt mbi turizmin dhe rrjedhimisht dhe në sektorinë e hotelerisë.

Performanca e kësaj takse ndër vite paraqitet si më poshtë:

në lekë

	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa e fjetjes në Hotel	67,327,716	83,170,711	98,004,072	113,966,275	35,815,582	57,890,811



Bazuar në të dhënat historike të realizimit të arkëtimit, parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel për vitet 2022–2024 duke marrë parasysh që mos frekuentimi i këtyre strukturave hoteliere mund të vazhdojë dhe për periudhën e parë të vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

	në lekë			
Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa e fjetjes në hotel	60,000,000	65,000,000	65,650,000	66,306,500

F) Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

	në lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa mbi Truallin	36,828,390	52,741,453	55,345,234	56,079,090	50,714,059	62,138,481



Bashkitë ndodhen në mungesë të bazës së të dhënave për këtë taksë si dhe në pritje të akteve ligjore plotësuese për taksimin e truallit, si një taksë qendrore për t'u aplikuar nga njësitë vendore dhe si rrjedhim, planifikimi bazohet në të dhëna historike dhe trendin vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit.

Për vitet 2022 – 2024, parashikimi të ardhurave nga kjo taksë jepet në tabelë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa mbi truallin	60,000,000	65,000,000	65,650,000	66,306,500

G) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Vlera e taksës në lekë/hektar/vit, miratuar me akte ligjore sipas bashkive dhe kategorisë së tokës, paraqitet në tabelë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII– X	1 800

Aktualisht, në mungesë të një baze të dhënash mbi tokën bujqësore, planifikimi bazohet në të dhënat historike të arkëtimit dhe trendit vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit për këtë taksë. Bashkia e Tiranës është drejt finalizimit të rregjistrimit të fermerëve të Tiranës, çka në vijim do të jetë një bazë e mirë të dhënash jo vetëm për t'u ardhur në ndihmë fermerëve, por

dhe për efekt të taksimit të drejtë, bazë mbi të cilën është parashikuar një rritje në nivelin e arkëtimeve nga kjo taksë për vitet në vijim.

	në lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa mbi tokën bujqësore	6,717,317	22,667,724	22,757,271	20,299,189	21,207,054	22,906,756



Parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2022 –2024, paraqitet si më poshtë.

	në lekë			
Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa mbi tokën Bujqësore	30,000,000	31,000,000	31,310,000	31,623,000

AGJENTËT TATIMORË JASHTË BASHKISË TIRANË

H) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.

Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme.

Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1,000 lekë/m² dhe për objektet e biznesit është 2,000 lekë/m². Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara.

Ecuria në vite për këtë taksë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	në lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	366,078,762	299,939,349	326,192,912	326,363,132	365,273,593	417,998,656



Bazuar në ecurinë faktike të viteve të kaluara dhe në informacionin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, parashikimi për vitet 2022 – 2024, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	320,000,000	400,000,000	400,000,000	400,000,000

D) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tiranë), para kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjetit, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuara për çdo muaj nga agjentët tatimor DPSHTRR.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura nga viti 2016 deri në vitin 2021, paraqitet në tabelen e mëposhtme:

në lekë

	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	280,082,106	285,325,027	406,962,488	433,146,135	442,712,995	426,687,674



Parashikimi për vitet 2022 – 2024, paraqitet si vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	420,000,000	420,000,000	420,000,000	420,000,000

J) Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale që u takon Njërive të qeverisjes vendore përfaqësojnë vlerën 2% e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Vlen të bëjmë me dije se për vitet 2018 dhe 2019, nuk është evidentuar asnjë e ardhur nga ky burim, ku strukturë mbledhëse është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, edhe pse ligji ka hyrë në fuqi që më 1 janar 2018, ndërsa gjatë vitit 2020 janë bërë dy ndarje të shumës së mbledhur në rang republike për vitin 2020 dhe dhe po kështu dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 duke marrë si bazë llogaritje përqindjen e numrit të banorëve për Bashkinë e Tiranës kundrejt numrit total të banorëve në vend.

Kështu, për vitin 2022 është parashikuar të bëhet arkëtimi i një pjesë të të ardhurave të mbledhura për vitet e mëparshme dhe pjesës së mbetur për vitin 2021, por ky parashikim nuk është bërë ende në buxhetin e shtetit.

Në parashikimet nga kjo taksë, ndryshimi në krahasim me parashikimet e mëparshme i atribuohet edhe mënyrës së shpërndarjes ndërmjet bashkive i të ardhurave të përgjithshme të njërive vendore nga TAP. Ndërkohë që sipas parashikimeve fillestare ligjore shpërndarja do të duhej të bëhej sipas juridiksionit ku mblidhet taksa, për arsye të pamundësisë teknike, sipas MFE, shpërndarja është bërë në bazë të numrit të popullsisë të njërive vendore. Në këtë mënyrë pjesa takuese për Bashkinë e Tiranës është më e ulët se ç'do të ishte nëse shpërndarja do të bëhej në bazë juridiksioni.

Bashkia e Tiranës, për vitet 2022–2024, nisur nga llogaritjet e përafërta mbi përkatësinë e pjesës takuese nga totali i parashikuar nga DPT, ka parashikuar të ardhurat për BT, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Taksa mbi të ardhurat personale	503,000,000	190,000,000	193,800,000	193,800,000

K) Tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Para vitit 2021 çdo biznes, i cili realizonte gjatë vitit fiskal një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohej detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtroheshin tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, ishte 5%. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, ishte 0 (zero) lekë në vit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël ishte Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore të cilat transferojnë të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogarinë e Bashkisë së Tiranës sipas afateve të përcaktuara në ligj.


Gjatë vitit 2020 me anë të ligjit 106/2020 “Për disa ndryshime në ligjin 8438 datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, shkalla e tatimit mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 milionë leke do të jetë 0 lekë duke filluar nga data 1 janar 2021.

Duke qenë se në vitin 2020 u bë shtyrja e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2021, realizimi i të ardhurave nga ky zë është i lidhur me 2020 dhe ky është vitit i fundit që realizohen të ardhura nga ky tatim.

Ky tatim ka pasur një realizim të ardhurash në nivelet e mëposhtme për vitet 2016 -2021:

në lekë

	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV	274,693,674	137,752,837	156,413,623	171,559,116	206,546,516	216,129,518



TARIFA VENDORE

L) Tarifa e pastrimit

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblidhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjellës – Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë.

Që prej vitit 2012 e në vijim tarifa e pastrimit mblidhet nga agjenti tatimor UKT sha, periudhë e cila shënon një rritje të ndjeshme të të ardhurave nga kjo tarifë, megjithëse jo në nivelin e kapacitetit. Si pasojë e reformimit të UKT sha, forcimit të administratës së institucionit dhe shtrirjes së kontrollit në të gjithë territorin e ri të Bashkisë së Tiranës, në vitin 2016 u arkëtuan thuajse dyfishi i të ardhurave të vitit 2015 dhe arkëtimi ka vijuar në nivele të qëndrueshme duke shënuar nivelin më të lartë në vitin 2018, ku përfshihen edhe disa detyrime të prapambetura të viteve të mëparshme që UKT sha nuk kishte arkëtuar pranë Bashkisë së Tiranës, por gjatë vitit 2021 gjithashtu taksa e pastrimit për familjarë ka arritur të ketë një ecuri mjaft pozitive dhe kështu duke shënuar nivelin më të lartë të arritur ndonjëherë nga kjo tarifë.

Paraqitja në vite e mbledhjes së këtyre të ardhurave është si më poshtë:

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Tarifa e pastrimit Familjarë	680,162,260	660,070,341	743,133,619	651,984,449	726,552,679	788,596,993



Lidhur me tarifën e pastrimit nga kategoria biznesi, vihet re një ecuri pozitive që tregon një ritëm në rritje të arkëtimeve në katër vitet e fundit, në sajë të mirëadministrimit të saj nga strukturat e DPTTV.

E njëjta tarifë për kategorinë “subjekte tregtare” paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Tarifa e pastrimit Subjekte	929,032,867	1,055,409,334	1,141,146,525	1,138,546,202	1,215,758,389	1,455,667,018



Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetin e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve aktive të evidentuara dhe nivelin e tarifës për vitin ushtrimor, në të ardhurat që trajtohen nga strukturat e DPTTV që do të kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti do të ndjekin edhe mbledhjen e tyre.

Për kategorinë familjarë parashikimi është bazuar në numrin e familjeve raportuar nga Agjenti tatimor.

Për vitin 2022-2024, parashikimi i arkëtimit të tarifës së pastrimit për kategorinë familjarë dhe subjektet tregtare, paraqitet si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Tarifa e pastrimit	2,185,215,000	2,315,424,000	2,342,655,000	2,370,220,000
- Familjarët	785,215,000	815,424,000	827,655,000	840,070,000
- Subjektet Tregtare	1,400,000,000	1,500,000,000	1,515,000,000	1,530,150,000

M) Tarifa për zënien e hapësirave publike

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m² të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit të indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.


Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo, etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.

- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, që pas ndryshimeve në vitin 2016. Realizmi i kësaj tarife në vitin 2021 pritet të mbyllet në një nivel më të lartë nga viti 2020 edhe pse për periudhën prill – shtator 2021 me anë të vendimit të marrë nga Keshilli Bashkiak Nr.50, datë 06.04.2021 për faljen e kësaj tarife për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e bar, restoranteve dhe hoteleve të klasifikuara si biznes i vogël.

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Tarifa për zënie e hapësirave publike	280,234,642	345,627,823	386,489,538	385,666,800	223,680,468	280,080,598



Parashikimi i të ardhurave të kësaj tarife për vitet 2022 - 2024, është si më poshtë:

	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Lloji i të ardhurave				
Tarifa për zënie e hapësirave publike	172,638,000	300,000,000	303,000,000	306,030,000
Tarifa për zënie e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella.	152,638,000	280,000,000	282,600,000	285,222,000
Tarifa për zënie e hapësirave në tregjet publike	20,000,000	20,000,000	20,400,000	20,808,000

N) Tarifa e parkimit

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia Tiranë për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara.

Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranë është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Në vitin 2021 arkëtimet kanë pësuar rritje në krahasim me vitin 2020 duke shënuar kështu dhe vlerë më të lartë të ketyre viteve të fundit.

Realizimi në vite dhe pritshmëria për vitin 2021, paraqiten në tabelën si më poshtë:

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Tarifa e parkimit	205,901,190	338,295,014	454,788,832	469,401,688	400,015,660	481,975,398



Parashikimi i të ardhurave të realizuara nga tarifatat e parkimit nga Tirana Parking për vitet 2022-2024 është bërë duke marrë parasysh kapacitetet e rrugëve me tarifim të cilat nga numërimi i fundit faktik në terren rezultojnë të jenë:

1. Zona A – 1135 vende me pagesë
2. Zona B – 749 vende me pagesë
3. Zona C – 259 vende me pagesë

Këto vende parkimi pretendohet që do të rriten me rreth 660 vende të reja si rezultat i shtimit të rrugëve të propozuara për tarifim.

Të ardhurat nga sektori i inspektimit në rrugë përveç shtimit të vendeve të reja është parashikuar të rriten dhe si pasojë e dy faktorëve të tjerë si:

- Shtimi i një metode të dytë alternative të pagesës së shërbimit të parkimit
- Shfrytëzimi më efikas i vendparkimeve aktuale

Në të njëjtën kohë është marrë parasysh vështirësia në realizim e të ardhurave që vjen si pasojë e dy faktorëve të mëposhtëm:

- Duke qenë se gjoha për mospagesën e tarifës së parkimit vendoset dhe arkëtohet nga Policia Bashkiake sjell vështirësi në realizimin e planit të parashikuar.
- Bllokime të rrugëve për shkak të kantierëve të ndërtimeve, punimeve në rrugë dhe aktiviteteve.

Së dyti, një rritje në të ardhurat e parashikuara nga tarifa e parkimit në masën 10% mesatarisht gati çdo vit të shtrirjes së parashikimit 2022-2024 paraqet parkimi në sheshe e lidhur me:

- Shtimin në vitin 2022 i shesh parkimit nëntokësor të kopshtit Zoologjik
- Rritjen e përdorimit të shërbimit parkim në nivelet perpara situates Covid -19

Së treti, synohet të mblidhen detyrimet e prapambetura nga subjektet që operojnë si “taksi” duke bërë të mundur rritjen e të ardhurave për vitin 2022 e në vazhdim.

Së katërti, numri i abonimeve i cili pretendohet të rritet me gati 10% duke marrë parasysh:

- Shtimi i Shesh parkimit nëntokësor “Sheshi Italia” gjatë vitit 2021, i cili duke qënë në një pozicion shumë të favorshëm të qytetit do të ndikojë në shtimin e paketeve të abonimit.
- Heqja e disa prej rrugëve me kapacitet të konsiderueshëm të vendparkimeve të Zonës A do të sjellë rritje të numrit të abonimeve.
- Tarifat e shërbimit të parkimit në rrugë gjithashtu ndikojnë për rritjen e numrit të abonimeve në sheshe.
- Shtimi në vitin 2022 i shesh parkimit nëntokësor të kopshti Zoologjik.

Së fundmi, duke marrë parasysh gjithë elementët e mësipërm dhe interesit të shprehur për kontrata të reja dhe rinovim të atyre ekzistuese nga subjektet private, edhe ky zë i të ardhurave të parashikuara nga Tirana Parking parashikohet të rritet me 5%.

Parashikimet për arkëtimin e tarifës së parkimit për vitet 2022 - 2024, paraqiten si më poshtë:
në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Tarifa e parkimit te automjeteve	505,603,000	574,603,000	626,334,000	681,570,000
Parkim me kontratë	145,603,000	156,400,000	164,110,000	173,102,000
Parkim me bileta	360,000,000	418,203,000	462,224,000	508,468,000

O) Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime

Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, vetëm një herë për të njëjtin aplikim për leje zhvillimi, infrastrukture dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Realizimi i të ardhurave nga kjo tarifë për periudhën 2016-2021 paraqitet si më pshtë:

	2016	2017	2018	2019	2020	në lekë I pritshmi 2021
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	186,913,234	188,375,674	462,929,640	477,529,142	594,764,275	683,080,235



Parashikimi për tarifën e shqyrtimit e kërkesës për leje për punime për vitet 2022 – 2024, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	432,000,000	432,000,000	432,000,000	432,000,000

P) Të ardhura të tjera

Në të ardhurat e tjera përfshihen kryesisht të ardhura destinacioni i të cilave nuk identifikohet që në momentin e arkëtimit dhe shpërndahen në destinacionet përkatëse sipas rakordimeve që realizohen nga DPTTV. Gjithashtu këtu përfshihen edhe të ardhurat nga qeratë e ndërtesave dhe trojeve, të ardhura nga penalitete administrative apo gjoba të vendosura nga DPTTV apo strukturave të tjera si Policia Bashkiake, Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorëve, etj.

Q) Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji.

në lekë

	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Të ardhura DPÇK	159,466,560	172,962,563	188,452,835	203,445,619	139,884,930	199,259,289
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	103,679,539	112,529,983	119,123,817	128,533,229	89,124,960	125,675,586
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	55,787,021	60,432,581	69,329,019	74,912,390	50,759,970	73,583,703



Parashikimi i të ardhurave për vitet 2022 – 2024, si më poshtë vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	151,000,000	152,384,000	152,384,000	152,384,000
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	78,800,000	80,152,000	80,152,000	80,152,000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve.

Të ardhurat e mbledhura nga pagesat e konvikteve të shkollave të mesme si më poshtë:

në lekë

	2016	2017	2018	2019	2020	I pritshmi 2021
Pagesa për Konviktet e Shkollave të Mesme	5,104,995	5,747,030	6,744,125	6,103,881	4,572,310	1,104,878



Siç mund të vihet re të ardhurat nga pagesat për Konviktet e Shkollave të Mesme janë gati zero duke marrë parasysh faktin që këto struktura akomoduese nuk janë përdorur për shkak të situatës së krijuar prej pandemisë Covid 19.

Parashikimi i të ardhurave nga pagesa në Konviktet e Shkollave të Mesme, për vitet 2022 – 2024, paraqitet si më poshtë:

në lekë				
Lloji i të ardhurave	Plani 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,600,000	4,200,000	4,200,000	4,200,000

III.2. Transfertat nga Buxheti i Shtetit


Transferta e Pakushtëzuar

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr. 68 datë 27.04 2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe udhëzimeve plotësues.

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës në periudhën 2015 – 2022 paraqitet si vijon:

Emertimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Plan							
Transferta e pakushtezuar	1,339,285,600	1,531,458,969	1,913,119,744	2,138,631,000	2,348,723,419	2,424,942,357	2,438,116,570	2,523,450,650
Trendi rritjes	11%	13%	20%	11%	9%	3%	1%	3%

Grafikisht:



Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022, do të jetë në vlerën 2,523,450,650 lekë, me një rritje prej 3 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Kjo transfertë përbën rreth 11 % të buxhetit të planifikuar për vitin 2022.

Transferta e pakushtëzuar duhet t'i sigurojë Njësive të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Në vitin 2022, ashtu sikurse edhe në vitin 2021, transfertat e pakushtëzuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale


Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” si Transferta Specifike do të vazhdojnë të financohen edhe në buxhetin e vitit 2022 nëpërmjet Transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Më konkretisht:

- Konviktet e arsimit parauniversitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)
- Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar
- Rrugët rurale
- Administrimi i pyjeve
- Ujitja dhe kullimi
- Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për Bashkinë e Tiranës në periudhën 2015 – 2022 paraqitet si vijon:

Emertimi	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Plan					
Transfertat e pakushtëzuara sektoriale	874,641,054	992,080,016	1,159,433,601	1,176,039,602	1,368,453,014	1,269,437,150
Trendi rritjes		12%	14%	1%	14%	-8%

Grafikisht:



Transferta e pakushtëzuar sektoriale nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022, do të jetë në vlerën 1,269,437,150 lekë, me një rënie prej 8 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm.

Arsyeja e kësaj rënieje është mos planifikimi këtë vit nga Qeveria Qëndrore të fondit për Mbrojtjen Civile i propozuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Kjo transfertë përbën rreth 5 % të buxhetit të planifikuar për vitin 2022.

Transferta e Kushtëzuar

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njërive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë si më poshtë, por nuk kufizohemi vetëm në ato të cituara:

Shërbimi i gjendjes civile si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Qendrat e Rregjistrimit të Bizneseve, si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative bëhet nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Përkrahja sociale, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

III.3. Burime te tjera financimi / Donacione

I. Donatorë vendas dhe të huaj

Tirana jonë, një qytet plot ngjyra, gjallëri, një qytet në zhvillim, me sfida e arritje të përditshme. Sfida që ua kemi dalë mbanë në mënyrën më të mirë. Tirana qyteti i të gjithëve, ku gjithkush mund të bëhet pjesë e zhvillimit, një jetese më të shëndetshme apo dhe mbështetje për ata që kanë më shumë nevojë. Tirana jonë çdo ditë e më shumë Solidare.

Të shumtë janë individët, bizneset, institucionet e ndryshme brenda e jashtë vendit, të cilët janë bërë pjesë e iniciativave dhe nismave të Bashkisë Tiranë. Të gjitha donacionet janë realizuar nëpërmjet financimit të tyre në forma të ndryshme si: sponsorizime, dhurime, grante, ndihma humanitare, ofrim shërbimesh, konsulenca, marrëveshje bashkëpunimi, etj.

Nisur nga fillimi i mandatit në vitin 2015, Bashkia Tiranë ka arritur të sigurojë fonde donatore në vlerën 2,496,037,130 lekë për projekte specifike dhe ka finalizuar 2,052 kontrata/marrëveshje të frytshme për financimin dhe realizimin e projekteve të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i bashkëpunimit/ projektit donator	Numri i Kontrata ve	Vlera e donacioneve
1	Projekti "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht"	238	304,827,207
2	Projekti i gjelbërimit, mbjelljet e reja në Tiranë, mobilim urban, rehabilitim i mjediseve publike, etj	944	405,203,285
3	Projektet e investimit në infrastrukturë, shkolla, rrugë, sinjalistike, etj	236	745,500,870
4	Dhurim automjete, pajisje, kompjutera, etj	155	158,997,518
5	Ndihma humanitare, projekte sociale, kulturore, etj	304	237,715,630
6	Marrëveshje Bashkëpunimi, Programe Financimi, Grante, etj	175	643,792,620
	Totali	2,052	2,496,037,130

- Një nga prioritetet e vazhdueshme nisur që prej fillimit të mandatit në vitin 2015 ka qenë sigurimi i kushteve sa më të mira për rritjen dhe edukimin e qytetarëve më të vegjël të Tiranës, këto përpjekje bënë të mundur çeljen e dy nismave: Projekti "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht". Me shumë dëshirë këto nisma u përkrahën e vazhdojnë të përkrahen nga donatorë të ndryshëm, të cilët kanë ofruar mbështetje pothuaj në gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe kanë mundësuar jo vetëm rehabilitimin apo ndërtimin nga e para të objekteve kopshte e çerdhe, por edhe mobilimin e pajisjen me gjithshka të nevojshme, për krijimin e ambjentëve të sigurt e funksionale, për grup moshat përkatëse. Ndërhyrjet në këto ambjente kanë qenë të shumta e të konsiderueshme. Këto ndërhyrje kanë përfshirë procese të ndryshme si: heqjen e lagështirës, rikonstrukcione të pjesshme, lysterje të mureve të brendshme dhe të jashtme, vendosje kondicionerësh, mobilime të ndryshme në krevatë, dyshekë, tavolina, karrike e shumë e shumë produkte të tjera, kompletimi i tualeteve si dhe kuzhinave me pajisje bashkëkohore të përshtatshme dhe të miratuara për përdorim për fëmijët e secilës grup-moshë. Gjithashtu ndërhyrje ka pasur edhe në ambientet e

jashtme të kopshteve e çerdheve, ndërhyrje që kanë konsistuar në: sistemime territori, rregullimi i trotuareve, lyerje fasade, mbjellje frutash, perimesh, lule, vendosja e këndeve të lojrave, etj. Në këtë kuadër janë realizuar 238 kontrata me donatorët dhe vlera e këtyre donacioneve shkon në 304,827,207 lekë, duke siguruar ndërhyrjen në pothuaj të gjitha këto godina.

- Një nismë e suksesshme iniciuar nga Bashkia Tiranë dhe që vazhdon të ketë po të njëjtën mbështetje si ditën e parë që u lancua nga të gjithë qytetarët dhe banorët në kryeqytet, institucionet, organizatat vendase dhe të huaja, ambasadat, bizneset, banorët e pallateve, nxënësit nëpër shkolla etj. është dhurimi i bimësisë dhe drurëve dekorativë për shtimin e gjelbërimit në Tiranë dhe zgjerimin e kurorës së gjelbër të Pyllit Orbital. Për rehabilitimin e lulishteve, mbjellje të ndryshme në parqet dhe rrugët e Tiranës, sipas planifikimit për pyllëzimin e Tiranës dhe rritjen e frymëmarrjes së kryeqytetit, mobilim urban, etj. në bashkëpunim dhe koordinim të nevojave dhe zbatimit të tyre me APR dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, si dhe në kuadër të nismave: “Pyllëzimi i Tiranës”, “Luaj@Tirana”, “Mbill pemën tënde”, “Dhuro një pemë”, “Dhuro një stol”, “Mbill një pemë në parkun/lagjen tënde” dhe “Vendos një stol në lagje apo në park”, janë realizuar 944 kontrata për projekte me fonde donatore në vlerën 405,203,285 lekë.
- Vëmendje të vazhdueshme nga Bashkia Tiranë u është kushtuar “Projekteve të investimit në infrastrukturë”. Këto përfshijnë investimet që janë bërë në objektet shkollore me mbështetjen e donatorëve; për rehabilitimin, kur ka qenë e mundur dhe ndërtimin tërësisht nga e para të tyre, kur ka qenë e nevojshme. Dëmet në këto objekte kanë qenë të shumta edhe pas tërmeteve të shtator dhe nëntor 2019. Në kohë rekord është punuar për rehabilitimin e tyre. Ndërhyrjet në objektet shkollore kanë prekur jo vetëm godinat, por edhe vendosje të sistemeve të ngrohjes, pajisje me kompjutera të laboratorëve të informatikës, mobilim të klasave, pajisje me mjete mësimore si dhe pajisje laboratorike, rehabilitimi i këndeve sportive dhe palestrave. Ndërhyrjet në infrastrukturë kanë pëfshirë punime si: rehabilitime në rrugë, vendosjen e sinjalistikave apo kangjellave mbrojtëse, instalimin e ndriçimit të teknologjisë inteligjente LED, risuvatimin e fasadave të pallateve, risistemimin e shtratit të lumenjve apo urave të ndryshme, etj. Këto ndërhyrje i kanë ndryshuar jo vetëm pamjen kryeqytetit, por kanë ndikuar edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët. Me mbështetjen e donatorëve Bashkia Tiranë ka përmirësuar kushtet në godinat e Rezidencave Studentore Universitare Nr. 1 dhe Rezidencës Studentore Universitare Nr. 2, duke krijuar ambjente bashkëkohore akomodimi, studimi e argëtimi. Përveç ndërhyrjes për rikonstruksion, rregullim të fasadave, dyerve, dritareve, meremetim të ambjenteve të brendshme, në godinat e RSU1 e RSU2 është bërë edhe sistemimi i ambjenteve të jashtme, mbjellja e pemëve, si dhe pajisja e një pjese të konsiderueshme të dhomave me shtretër e mobilje të reja. Me fonde donatore është bërë i mundur rikonstruksioni apo ndërtimi nga e para i disa Qendrave Shëndetësore, të cilat kanë patur nevojë për ndërhyrje edhe pas dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e nëntorit 2019. Në përpjekje për të mundur një cilësi jetese më të mirë Bashkia Tiranë, përkrah iniciativat për përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke përdorur burime energjie të cilat ulin ndotjen, si përdorimi i makinave elektrike. Kësaj iniciative i janë bashkuar institucione që kanë dhuruar vendosjen e aparateve për karrikimin e automjeteve në pika të ndryshme në kryeqytet. Janë finalizuar 236 kontrata me donatorët për projekte në infrastrukturë dhe është përthithur shuma e financimit në vlerën 745,500,870 lekë.
- Në vazhdimësi përpjekjeve të Bashkisë Tiranë për të ndihmuar shtresat në nevojë si: fëmijët dhe familjet në nevojë apo në situatë rruge, personat me aftësi të kufizuara e në

pamundësi ekonomike, të moshuarit, apo çdo familje në Tiranë e gjendur në kushtet e emergjencave i janë përgjigjur pa hezitim e shumë shpejt donatorë të ndryshëm si ; biznese, shoqata, institucione apo dhe individë. Të shumtë kanë qenë donatorët në mbështetje të nismës “Solidaritet për dëmet e tërmetit”, promovuar nga Bashkia Tiranë që u janë gjendur pranë banorëve të dëmtuar në një kohë rekord me; çadra (si një strehim i përkohshëm), pako ushqimore, veshje, këpucë, elektroshtëpiake etj. Të tjerë donatorë kanë kontribuar e vazhdojnë të kontribojnë për plotësimin e nevojave në magazinat e emergjencave të qytetit apo për realizimin e aktiviteteve bamirëse e komunitare dhe të furnizimit të përditshëm me ushqime në mencat sociale të qytetit. Vijon puna e është në fazën përfundimtare rehabilitimi e ndërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmetet. Fillimi i pandemise covid-19, tregoi edhe njëherë mbështetjen për ata që kanë më shumë nevojë. Donatorë të shumtë kanë dhënë kontributin e tyre për rikonstruksionin e përmirësimin e infrastrukturës në Qendrat Sociale. Tirana është pa dyshim një qendër kulture, ndaj të shumtë janë donatorët të cilët dhurojnë pranë bibliotekave libra nga biblioteka e tyre personale, apo të tjerë donatorë që përkrahin nismat e Bashkisë për krijimin e pasurimin e muzeumeve. Janë mbyllur me sukses deri sot 304 kontrata për mbështetjen e shtresave në nevojë në territorin e Bashkisë Tiranë në vlerën donatore prej 237,715,630 lekë.

- Nga donatorë të ndryshëm është siguruar mbështetje, që përfshin: pajisje të ndryshme në ndihmë të administratës, policisë bashkiake, zjarrfikëseve, institucioneve të varësisë apo drejtorive të aparatit të Bashkisë Tiranë, në kuadër të përmirësimit të shërbimeve ofruar qytetarëve dhe qytetit. Janë finalizuar donacionet me nënshkrimin e 155 kontratave në vlerën 158,997,518 lekë.
- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit për financimin dhe mbështetjen e nevojave dhe projekteve të ndryshme të Bashkisë Tiranë për investime, ndërhyrje në infrastrukturë, asistencë teknike apo ngritje kapacitetesh, studim fizibiliteti të standardit evropian etj, janë përthitur fonde në formë granti dhe financimesh të ndryshme. Këtu përfshihen të gjitha marrëveshjet që janë lidhur me donatorë të ndryshëm, individë apo kompani, për rehabilitimin e ndërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmetet. Totali i marrëveshjeve të lidhura është 175 që arrijnë fondin prej 643,792,620 lekë.

III.4 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2022 -2024

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022 - 2024, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 23,600,140,800 lekë, 20,874,930,000 lekë dhe 20,586,228,000 lekë.

Në parashikimin e viteve buxhetore është përfshirë edhe fondi që planifikohet të mbartet nga viti paraardhës. Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv të arkëtimit të tyre, ku përfshihen të ardhurat nga dy burime financimi, të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme sektoriale.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për vitet 2022 - 2024, parashikohen të ndara si më poshtë si në kuadrin e kategorisë ekonomike dhe sipas klasifikimit funksional:

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

në lekë

PBA 2022-2024								
Raport		Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia		Tirane						
Shpenzimet e Bashkisë (000ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxh.Fillestar	Perfundimtar	Plan	Plan	Plan
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	4,301,299,872	4,574,961,615	5,421,056,401	5,664,585,094	5,672,550,809	5,672,550,809	5,672,550,809
Sigurime Shoqërore & Shëndetsore	601	719,960,442	758,469,639	860,869,027	891,258,518	901,723,724	901,723,724	901,723,717
Korentë								
Mallra dhe Sherbime	602	5,778,926,286	6,312,940,582	6,285,898,624	7,643,109,507	6,314,496,518	6,167,363,068	6,682,586,099
Subvencion/Transferta të Brendshme	603/604	44,327,562	30,533,682	206,501,348	217,160,265	421,660,648	131,054,400	88,326,400
Transferta të Jashtme	605	36,000	-	-	-	-	-	-
Transferta për Familje & Individë	606	569,623,345	275,179,325	416,006,103	388,376,103	315,727,000	345,500,000	400,500,000
Fondi Rezerve	609	-	-	200,000,000	188,346,500	190,000,000	220,000,000	260,000,000
Shpenzime Kapitale								
Aktive të paprekshme	230	185,003,921	117,341,571	410,539,097	424,218,766	620,925,136	220,176,116	-
Aktive të prekshme	231	6,723,421,699	5,941,653,711	6,639,048,132	7,662,042,272	9,063,056,965	7,216,561,883	6,580,540,975
Transferimet Kapitale	232	10,181,783	98,448,949	93,448,849	132,000,000	100,000,000	-	-
Totali		18,332,780,909	18,109,529,074	20,533,367,580	23,211,097,025	23,600,140,800	20,874,930,000	20,586,228,000

Grafikisht: Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.





Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas klasifikimit funksional

në lekë

FUNKSIONI	KODI FUNK.	KODI NËNIFUNK.	KODI PROGR.	PROGRAMI	Fakti		Buxheti Fillestar	Perfundimtar	Plan		
					2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
SHËRBIMET TË PËRGJITHSHME PUBLIKE	01	011	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	2,323,300,966	2,468,899,675	2,870,608,622	3,189,856,786	2,847,771,753	2,581,914,604	2,651,495,630
			01120	Çështjet financiare dhe fiskale	281,533,125	293,335,161	314,291,000	343,151,000	353,136,358	313,399,332	315,399,332
			01170	Gjendja Civile	-	-	-	-	-	-	-
			017	Pagesa e shërbimit të borxhit të brendshëm	-	-	-	-	-	-	-
RENDITJE DHE SIGURIA PUBLIKE	03	031	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	407,063,669	404,307,865	510,904,300	517,675,300	517,064,339	490,244,339	490,244,339
			032	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	444,756,824	500,292,765	687,010,029	630,161,147	335,276,174	212,713,929	212,713,929
			03600	Marëdhëniet në Komunitet	-	-	-	-	-	-	-
ÇËSHTJET EKONOMIKE	04	041	04130	Mbështetja për zhvillimin ekonomik	27,045,712	13,667,000	73,000,000	73,000,000	33,000,000	34,000,000	34,000,000
			04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	54,280,707	51,319,215	75,912,100	75,912,100	68,612,578	73,913,978	71,208,678
		042	04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	246,594,353	288,373,009	283,100,725	316,969,934	275,418,079	244,839,043	242,978,043
			04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujtes dhe kullimit	48,578,509	20,392,907	21,640,493	57,072,907	22,506,113	22,506,113	22,506,114
			04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	9,370,386	9,008,889	9,955,060	10,642,664	10,353,262	10,353,263	10,353,263
		045	04520	Rrjeti rrugor rural	3,646,673,021	3,252,494,501	2,229,329,130	2,159,707,181	2,694,617,454	3,003,250,300	1,974,945,006
			04570	Transporti publik	144,272,515	189,029,286	361,875,136	346,434,258	556,607,185	230,029,774	309,171,854
		047	04740	Projekte Zhvillimi	5,850,684	23,861,282	45,891,909	101,441,909	262,863,520	152,320,000	90,120,000
			04760	Zhvillimi i turizmit	18,406,000	14,207,246	15,000,000	15,000,000	15,000,000	16,000,000	17,000,000
		MBROJTJA E MJEDISIT	05	051	05100	Menaxhimi i mbetjeve	1,859,775,587	1,976,105,600	2,019,119,069	2,467,634,401	2,028,000,000
053	Reduktimi i ndotjes				-	-	-	3,837,945	9,837,945	6,000,000	6,000,000
STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	06	061	06140	Planifikimi urban Vendor	826,463,359	797,572,735	2,116,904,095	2,802,245,204	2,502,603,295	1,574,242,307	1,582,222,361
			06210	Programet e Zhvillimit	24,859,349	107,387,327	133,448,849	162,355,346	170,000,000	50,000,000	70,000,000
		062	06280	Shërbimet publike vendore	2,818,761,833	3,035,289,570	3,023,072,298	3,203,098,670	4,502,691,910	4,161,924,477	3,891,942,995
			063	Furnizimi me ujë	-	-	-	-	-	-	-
ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA	08	064	06440	Ndriçim mugësh	345,291,733	275,997,340	326,000,000	386,305,357	348,666,000	310,000,000	360,000,000
			08130	Sport dhe Argëtim	309,842,295	272,278,560	251,270,386	334,917,456	376,317,457	295,032,789	257,554,789
		082	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	396,792,335	479,776,504	393,885,035	566,251,420	556,271,425	420,597,683	416,097,383	
ARSIMI	09	091	09120	Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë	2,785,142,865	2,037,518,476	2,295,461,837	2,598,628,729	2,746,987,102	2,485,827,119	2,633,569,845
			09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	915,714,315	1,221,382,664	1,763,433,614	1,909,023,037	1,514,640,263	1,781,202,922	1,929,986,415
		092	Arsimi profesional	102,883,388	105,368,215	114,832,223	178,501,705	131,835,553	102,859,513	102,859,514	
MBROJTJA SOCIALE	10	101	10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	17,331,950	17,057,150	18,960,000	18,960,000	17,070,000	17,070,000	17,070,000
			102	Sigurnimi shoqëror	-	-	-	-	-	-	-
		104	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	170,923,602	176,072,384	258,083,620	292,556,120	296,173,035	289,888,515	291,988,508	
		105	Papunësia, arsimit dhe aftësim	8,128,541	13,237,664	25,000,000	25,000,000	25,000,000	25,000,000	25,000,000	
		106	Strehim Social	93,153,295	65,296,084	165,000,000	166,800,000	191,800,000	221,800,000	271,800,000	
			04910	Fondi rezerve	-	-	150,000,000	138,346,500	150,000,000	170,000,000	200,000,000
			04940	Fondi i Kontingjencës	-	-	50,000,000	50,000,000	40,000,000	50,000,000	60,000,000
					18,332,780,909	18,109,529,074	20,533,367,580	23,211,097,025	23,600,140,800	20,874,930,000	20,586,228,000

Grafikisht: Shpenzimet totale të Bashkisë sipas klasifikimit funksional



Përsa i përket buxhetit të planifikuar për vitin 2022, krahasuar me vitin buxhetin fillestar të vitit 2021 kemi një rritje me 15 %. Duke qenë se është operuar në një vit financiar ku fokus i është dhënë Rindërtimit, projekte të planifikuara me fonde nga Qeveria Qëndrore, ka sjellë që ecuria e projekteve të miratuara me të ardhurat e Bashkisë Tiranë të ketë një realizim më të ngadaltë, fokus ky i cili do të rifuqizohet me buxhetin e vitit 2022 dhe vitet në vijim 2023 dhe 2024.

Kjo ecuri ka sjellë një gjëndje të lartë të fluksit të parave të cilin po e menaxhojmë duke pasur si fokus planifikimin në dy shtyllat kryesore. Njëra shtyllë ka të bëjë me planifikimet e marra gjatë vitit aktual. Përmendim këtu që në vitin e ardhshëm është menaxhuar të mbulohen këto angazhime në vlerën 63% për Aparatin e Bashkisë Tiranë dhe 80% për angazhimet e marra nga Institucionet e Varësisë për shpenzimet kapitale.

Shtylla tjetër ka të bëjë me hovin që do të marrin investimet e reja të planifikuara të realizohen për qytetin dhe njësitë administrative të cilat fillojnë në vitin 2022 dhe shtrihen në vitet 2022 – 2024.

III.4.1 Shpenzime Kapitale

Për vitin 2022 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 9,783,982,101 lekë ose 41 % ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2023 dhe 2024, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 7,466,737,999 lekë dhe 6,580,540,975 lekë.

Për vitin 2022 peshën më të madhe e zënë shpenzimet kapitale per programet e Zhvillimit të Komuniteti, Transportit dhe Urbanistikës.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2022-2024, sipas programeve buxhetore:

në lekë						
Funksioni	Plan 2021	Plan 2022	% ne strukturë	Plan 2023	Plan 2024	
1	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	256,863,154	298,382,708	3%	23,000,000	17,000,000
2	Shërbime të huamarjës vendore		0	0%	0	0
3	Shërbime policore	3,420,000	6,820,000	0%	0	0
4	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	227,459,355	122,562,245	1%	0	0
5	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	10,075,300	4,738,600	0%	10,040,000	7,334,700
6	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	48,579,293	8,470,000	0%	2,470,000	0
7	Transporti	1,472,267,850	2,083,583,367	21%	1,717,470,802	1,247,594,588
8	Industri të tjera	101,441,909	262,883,520	3%	152,320,000	90,120,000
9	Menaxhimi i mbetjeve	0	0	0%	0	0
10	Reduktimi i ndotjes	0	0	0%	0	0
11	Urbanistika	2,599,548,904	2,296,834,295	23%	1,394,258,307	1,402,238,361
12	Zhvillimi i komunitetit	2,045,215,470	3,273,953,350	33%	2,813,185,918	2,478,204,435
13	Ndriçimi i rrugëve	0	0	0%	0	0
14	Shërbimet rekreative dhe sportive	17,302,000	23,312,668	0%	0	0
15	Shërbimet kulturore	78,433,635	89,354,994	1%	49,115,900	11,845,600
16	Arsimi bazë dhe parashkollor	547,266,078	742,437,633	8%	473,026,650	575,569,376
17	Arsimi parauniversitar	803,956,170	564,263,801	6%	801,850,422	750,633,915
18	Sëmundje dhe paaftësi	0	0	0%	0	0
19	Familje dhe fëmijët	6,431,920	6,384,920	0%	0	0
20	Papunësia	0	0	0%	0	0
21	Strehimi	0	0	0%	0	0
22	Fondi rezerve	0	0	0%	0	0
23	Fondi i Kontigjences	0	0	0%	0	0
TOTALI		8,218,261,038	9,783,982,101	100%	7,436,737,999	6,580,540,975

III.4.2. Shpenzime për Personelin

Shpenzimet e personelit për vitet 2022-2024 parashikohen si më poshtë:

në lekë						
	Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2021	Plan 2022	% ne strukturë	Plan 2023	Plan 2024
1	Shpenzime personeli	6,555,843,612	6,574,274,533	28%	6,574,274,533	6,574,274,526

Gjatë vitit 2022, me qëllim rritjen e cilësisë dhe menaxhimit sa më me eficientë të burimeve njerëzore si dhe transparencën e administratës ndaj publikut, për t'i shërbyer sa më mirë këtij të fundit dhe për përftimin e interesave maksimale, për institucionin e Bashkisë së Tiranës janë propozuar nga Institucionet në varësi të saj ndryshimet e mëposhtme strukturore si dhe kërkesat për shtesa në numër punonjësish si më poshtë vijon;

Aparati i Bashkisë së Tiranës

Për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të zhvillimit e zgjerimit të veprimtarive të qytetit dhe shtimit të funksioneve ka qenë i domosdoshëm riorganizimi e shtimi i burimeve njerëzore të strukturës organike të Aparatit të Bashkisë me një shtesë total prej 28 punonjës në kategoritë Drejtor, pergjegjes sektori, specialist e punonjës mbështetës.

Duke parë anën funksionale dhe organigramën e përgjithshme aktuale të Bashkisë së Tiranës janë propozuar ndryshimet e mëposhtme strukturore në numër punonjësish me qëllim rritjen e cilësisë dhe menaxhimit sa më me efikasitet të këtyre funksioneve si më poshtë vijon;

Krijimi i Drejtorisë së Apelimit, zgjerimi i kapaciteteve me burime njerëzore për Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Drejtorisë së Auditit, Drejtorisë së Finances, si dhe punonjës mbështetës.

Shtesa e propozuar në total është për 28 punonjës me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 31,237,000 leke.

Njesitë Administrative

Përdorimi i platformës për aplikimin online të rindërtimit, problematikat në ruajtjen dhe menaxhimin e territorit, administrimit të sistemit të përfituesve për ndihmën ekonomike, ka bërë të nevojshëm shtim të organikës për Njesitë Administrative prej 6 punonjës të kategorisë specialist IV-a, duke krijuar në Njesitë më mëdha Administrative, Njësinë e Vlerësimit të nevojave të rastit me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 4,317,000 leke.

Projekti Arkiva

Referuar Vendimit Nr.49, datë 03.05.2019 të Këshillit Bashkiak për “Një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin Nr.159, datë 21.12.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2019” ku pranë strukturës Institucionit të Bashkisë së Tiranës funksionon struktura mbështetëse me 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës arkivi të cilët do të bëjnë të mundur arkivimin/konservimin e dokumentacionit të institucionit dhe dorëzimin e tyre pranë njesive të arkivit qëndror. Meqenëse puna përgatitore e arkivimit të dokumentacioni kërkon vijueshmëri të gjatë kohore, propozohet rinovimi i kontratës për një afat të pacaktuar për këtë grup punonjësish.

Qendra Rinore "Ten"

Qendra Rinore “TEN” me numër punonjësish aktual prej 13 vetë, funksionon si institucion ku marrëdhëniet financiare mbulojnë nga Aparati Bashkisë, me qëllim funksionimin e pavarur dhe rritjen e efikasitetit të këtij institucioni, propozohet që të jetë me llogari më vete dhe në këtë kuadër lind nevoja e shtimit të sektorit të financës. Për realizimin e ndryshimeve të mësipërme kërkohet të shtohen 3 punonjës me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 2,963,000 leke.

Tirana Parking

Tirana Parking, ka si detyrë funksionale administrimin e shërbimit të Parkimit Publik me/pa Pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nën tokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim.

Me qëllim, efektivitetin e punës, kthimin në kohë , ofrimit të shërbimeve me cilësi dhe disponueshmëri, nivel të lartë profesionalizmi dhe kompetence, në relacionin për PBA 2022-2024 ka paraqitur kërkesat plotësimin e strukturës me burime të tjera njerëzore, konkretisht:

Me zgjerimin e shesheve për parkim në qytetin e Tiranës, shtohet edhe përgjegjësia për mirëmbajtjen e tyre dhe zgjidhjen e problemeve rast pas rasti,, rehabilitimit në kohë të dëmtimit fizik të ambjentit, sigurimit të stabilitetit në marrëdhënie me qytetarët si dhe kontributit në ruajtjen e imazhit të këtij shërbimi, prandaj lind nevoja e shtimit të pozicioneve teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme.

Gjithashtu zgjerimi dhe shtrirja e Projektit të Rezidentit në të gjithë qytetin e Tiranës., duke qënë se, janë pajisur me sinjalistikë horizontale dhe vertikale 25 blloqe rezidenciale dhe aktualisht proceset e punës për mirëfunksionimin e këtij projekti mbulohen nga Sektori i Inspektimit në Rugë, Drejtoria e Administrimit të Shërbimit të Parkimit me Pagesë sheh si tepër të nevojshme krijimin e Sektorit të Rezidentit.

Për realizimin e ndryshimeve të mësipërme kërkohet të shtohen 7 punonjes me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 6,569,000 leke.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik,

Shtimi i volumit të punës, që përfshin mirëmbajtjen:

- mirëmbajtjen me efçense të sipërfaqeve të rrugëve kryesore dhe dytësore, trotuarëve e shesheve publike, zgarave e kunetave të ujrave të bardha, të rrugëve rurale, sipas inventarit të tyre dhe administrimin e ujrave në të gjitha njësitë administrative

- mirëmbajtjen e stacioneve të pompave, pastrimin e kanaleve kulluese, stacioneve të pompave, hidrovoreve, digave, detyra të mëparëshme të Bordit të Kullimit

- mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik dhe vënien në efçencë 100% të rrjetit semaforëve dhe sinjalistikës rrugore, në të gjitha njësitë administrative

- përballimin e të gjithë situatave të përditshme dhe emergjente, që realizohen me mjetet aktuale dhe shtesë të transportit, të disponueshme në parkun e makinerive të drejtorisë, për mirëmbajtje

Për përballimin e kërkesave dhe funksione të shtuara në të gjitha drejtoritë, për burime njerëzore si pasojë e ngarkesës së punës, propozohet shtesa me 20 punonjës për riorganizimin e strukturës organike me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022, në shumën 13,436,000 leke.

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit,

APR ka në administrim dhe mirëmbajtje parqet (Parku i Madh i Liqenit, Parku Zoologjik, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Tiranë dhe Pezë), Kurorën e Gjelbër, Fondin Pyjor e Kullosor, organizimin e aktiviteteve Rekreative, mirëmbajtjen e këndeve të lojrave, mirëmbajtjen e Parkut Olimpik. Rritja e sipërfaqeve në administrim, numri i lartë i këndeve të lojrave që vinë në rritje, fushatat e mbjelljeve në çdo vit etj.kërkojnë dhe shtim të burimeve njerëzore.

Investimet në Parkun e Farkës që ka sjellë rritjen e sipërfaqeve si dhe të frekuentimit, lindin nevojën e mirëmbajtjes, ruajtjes, pastrimit e mbjelljeve.

Investimet e reja në terrenet sportive si fushat e tenisit, fushat multisportive, parku helen, shtojnë përgjegjësinë lidhur me mirëmbajtjen, menaxhimin e aktiviteteve te ndryshme.

Riinvestimi i Zooparkut që ka më se një vit që ka filluar, kërkon rritjen e standarteve dhe nivelit të shërbimit dhe ngritjen e Drejtorisë së Zoo-Parkut.

Gjithashtu shtrirja e madhe e sipërfaqeve të fondit pyjor, rrit shkallën e përgjegjesisë së administrimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së tij, kërkon shtim të sektori për administrimine parqeve natyrore dhe të kurorës së gjelbër. Bazuar në zgjerimin e sipërfaqeve që administron APR kërkon riorganizimin e strukturës organike dhe shtimin e saj me 50 punonjës me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 30,653,000 leke.

Qendrat Komunitare

Qendrave Komunitare: "Të qëndrojmë së bashku", Qendrës Komunitare Multidisiplinare, Qendrës Komunitare "Gonxhe Bojaxhi", Qendrës Komunitare "Shkozë", si dhe Qendrës Sociale "Strehëza Tiranë", në bazë të rritjes së aktivitetit të tyre dhe shtrirjes e zgjerimit të shërbimit për shtresat në nevojë, si dhe në bazë të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm për riorganizimin e tyre, do tu shtohet respektivisht nga një punonjës për vitin 2022 me efekt financiar shtesë prej 923 000 lekë për secilën.

Agjencia e Shërbimeve Funerale

ASHF për përmirësimin e shërbimit të varrezave, ka kërkuar një shtesë prej 18 punonjësish, nga të cilët 5 në administratë dhe 13 vetë në njësitë administrative. Kjo shtesë është e domosdoshme për riorganizimin e strukturës e evidentuar dhe si rekomandim nga Audit i Brendshëm i Bashkisë Tiranë, duke përcaktuar që pozicionet e punës në nivel drejtues, përgjegjës sektori /zyre/“ përgjegjës varrezash”, të jenë në përputhje me shkallën e hierarkisë së raportimit dhe monitorimit, si dhe në baze të numrit të punonjësve të varësisë dhe nivelit të pagave”. Struktura organizative nga 132 punonjës shkon në 150 punonjës gjithsej.

Shtesa prej 13 punonjësish të mirëmbajtjes në Njësitë Administrative është e nevojshme pasi sipërfaqet e pastrimit të varrezave publike janë jo vetëm të konsiderueshme, por dhe të copëzuara sipas fshatrave apo lagjeve në to. Largësia dhe terrenet e vështira ku nuk ka lëvizje urbane e vështirëson edhe më tej punën duke krkuar rritjen e standardit të pastrimit.

Efektet financiare të shtesës së 18 punonjësve për vitin 2022 janë në shumën 14,236,000 lekë.

Agjencia e Industrisë Kreative

Krijimi i Agjencië së Industrisë Kreative, që është propozuar për miratim, ka si qëllim rivitalizimin e Kinemave të Qytetit, shfaqjen e filmave Shqiptarë dhe të huaj në sallat e kinemave, organizimin e javëve të filmit si dhe festivaleve të filmit, ideimin dhe organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore, edukuese dhe argëtuese për të gjitha moshat, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe qeradhënien e ambienteve dhe sallave.

Për realizimin e veprimtarisë së këtij Institucioni është menduar si fillim krijimi i një strukture prej 12 punonjësish me efekt financiar të shpenzimeve të personelit për vitin 2022 në shumën 10,959,000 lekë.

Agjencia e Rinisë

Agjencia e Rinisë, si një strukturë e ngarkuar në vendimin nr. 126, datë 15.10.2021, të këshillit Bashkiak “Për miratimin e draftmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Kombëtar Rinor “Për financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022” dhe manualit për menaxhimin e tij, që kanë për qëllim financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022”, ku Tirana në vitin 2022 do të jetë Kryeqyteti Evropian i të Rinjve, si edhe duke patur në fokus qëllimin e funksionimit të saj, për t’i dhënë një mundësi studentëve që aktualisht studiojnë në IAL

përkatëse, për përfshirjen dhe aftësimin e tyre në tregun e punës, e më konkretisht nëpërmjet këtij programi, i cili është krijuar për të rinjtë dhe fokus ka zhvillimin e tyre, kërkon shtimin e 30 studentëve part-time në sportelet e kartës së studentit për Agjencinë e Rinisë për një periudhën 6 mujore gjatë vitit 2022.

Pagesa do të jetë në formë honorari në shumën 15 000 lekë në muaj. Efekti financiar për këto honorare do të parashikohen në artikullin 602 të Agjencisë së Rinisë për vitin 2022 në shumën 2,700,000 leke.

III.4.3. Shpenzime Operative dhe të tjera

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 7,241,884,166 lekë për vitin 2022, 6,863,917,468 lekë për vitin 2023 dhe 7,431,412,499 lekë për vitin 2024. Këto shpenzime përbëjnë 31% të totalit të buxhetit për vitin 2022 dhe përbëhen nga:

- Shpenzimet operative të aparatit të Bashkisë dhe institucioneve në varësi;
- Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës;
- Transferta të tjera për individët

Për periudhën afatmesme 2022-2024, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, është llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak.

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i strehimit, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si shporta e bese , të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë vitit 2022.

Për t'u përmendur si aktivitet që do të kryhet gjatë vitit 2022 , projekt i inicuar që në muajt e fundit të vitit 2021 është edhe projekti "Tirana European Youth Capital 2022". Titulli "Tirana European Youth Capital 2022 ", i njohur si European Youth Capital 2022 është një titull i cili jepet një qyteti evropian në kuadër të nismës European Youth Capital, titull i fituar për vitin 2022 nga qyteti i Tiranës, me fokus zhvillimin e 8 programeve në të cilën përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë që i dedikohen të rinjve 14-29 vjec, të cilat janë:

- 1- Rinia bën ekonomi krijuese dhe Inovacion
- 2- Rinia krijon Kulturë
- 3- Rinia zhvillon Kapacitetet
- 4- Rinia merr pjesë
- 5- Rinia Diverse
- 6- Të rinjtë janë Europeanë
- 7- Rinia dhe Shëndeti mjedisor
- 8- Hapësirat për të rinjtë

Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në rritjen e financimit për shërbimet publike me qëllimin e përdorimit të tyre për përmbushjen e funksioneve kryesore të Bashkisë së Tiranës.

Peshën më të madhe në shpenzimet operative e mbajnë funksionet prioritare të Bashkisë së Tiranës: shërbimet publike vendore, arsimiti parashkollor dhe parauniversitar, transporti rrugor, shpenzime të cilat financojnë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetaëve.

Shpenzimet operative dhe të tjera për vitet 2022-2024 parashikohen sipas programeve buxhetore si më poshtë:

në lekë				
Funksioni	Plan 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet				
1 financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	1,469,598,032	1,035,551,071	1,005,339,604	1,082,920,630
2 Shërbime të huamarrjes vendore		0	0	0
3 Shërbime policore	34,011,000	30,000,000	10,000,000	10,000,000
4 Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	226,349,199	60,000,000	60,000,000	60,000,000
Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës				
5	105,000,000	63,000,000	64,000,000	64,000,000
6 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	161,487,012	125,141,569	100,562,534	101,171,537
7 Transporti	639,689,438	678,889,058	527,057,058	547,770,058
8 Industri të tjera	15,000,000	15,000,000	16,000,000	17,000,000
9 Menaxhimi i mbejtjeve	2,467,634,401	2,028,000,000	2,028,000,000	2,028,000,000
10 Reduktimi i ndotjes	3,837,945	9,837,945	6,000,000	6,000,000
11 Urbanistika	45,000,000	35,785,000	10,000,000	10,000,000
12 Zhvillimi i komunitetit	525,855,346	550,000,000	549,999,999	635,000,000
13 Ndrërimi i rrugëve	386,305,357	348,666,000	310,000,000	360,000,000
14 Shërbimet rekreative dhe sportive	241,171,025	280,450,000	222,478,000	185,000,000
15 Shërbimet kulturore	405,801,385	361,364,648	265,930,000	298,700,000
16 Arsimiti bazë dhe parashkollor	591,906,110	621,771,000	630,022,000	675,222,000
17 Arsimiti parauniversitar	557,014,525	416,089,515	416,089,513	616,089,514
18 Sëmundje dhe paafësi	18,960,000	17,070,000	17,070,000	17,070,000
19 Familje dhe fëmijët	162,225,100	158,468,360	158,568,760	160,668,760
20 Papunësia	25,000,000	25,000,000	25,000,000	25,000,000
21 Strehimi	166,800,000	191,800,000	221,800,000	271,800,000
22 Fondi rezerve	138,346,500	150,000,000	170,000,000	200,000,000
23 Fondi i Kontigjences	50,000,000	40,000,000	50,000,000	60,000,000
TOTALI	8,436,992,375	7,241,884,166	6,863,917,468	7,431,412,499

Bilanci përmbledhës i të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për periudhën 2022 – 2024 paraqitet në tabelën si më poshtë në lekë:

	Emërtimi	Plan 2021	PARASHIKIMI		Ne %	PARASHIKIMI 2023	PARASHIKIMI 2024
			2022				
I	Të ardhura të taksueshme	9,859,760,000	9,721,200,000	41%	9,754,260,000	9,783,812,000	
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,612,560,000	2,640,000,000	11%	2,659,700,000	2,679,597,000	
a	Familjarët	658,560,000	670,000,000	0	670,000,000	670,000,000	
b	Subjektet Tregtare	1,954,000,000	1,970,000,000	0	1,989,700,000	2,009,597,000	
2	Taksa mbi token Bujqesore	30,000,000	31,000,000	0	31,310,000	31,623,000	
3	Taksa mbi truallin	60,000,000	65,000,000	0%	65,650,000	66,306,500	
4	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	0	0	0%	0	0	
5	Taksa e fjetjes në hotel	60,000,000	65,000,000	0%	65,650,000	66,306,500	
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	4,800,000,000	4,800,000,000	20%	4,800,000,000	4,800,000,000	
7	Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e pa	320,000,000	400,000,000	2%	400,000,000	400,000,000	
8	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	420,000,000	420,000,000	2%	420,000,000	420,000,000	
9	Taksa mbi te ardhurat personale	503,000,000	190,000,000	1%	193,800,000	193,800,000	
10	Taksa e tabelës	300,200,000	300,200,000	1%	303,250,000	306,330,000	
a	Tabelë identifikuese/sinjalizuese	200,000	200,000	0%	250,000	300,000	
b	Tabelë reklamuese	300,000,000	300,000,000	1%	303,000,000	306,030,000	
11	Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	754,000,000	810,000,000	3%	814,900,000	819,849,000	
	Familjarët	314,000,000	320,000,000	1%	320,000,000	320,000,000	
	Subjektet Tregtare	440,000,000	490,000,000	2%	494,900,000	499,849,000	
II	Të ardhura jo tatimore	4,355,676,000	4,686,053,000	20%	4,770,670,000	4,852,416,000	
1	Tarifat	3,308,276,000	3,636,317,000	15%	3,720,934,000	3,802,680,000	
a	Tarifa e pastrimit	2,185,215,000	2,315,424,000	10%	2,342,655,000	2,370,220,000	
a.1	Familjarët	785,215,000	815,424,000	3%	827,655,000	840,070,000	
a.2	Subjektet Tregtare	1,400,000,000	1,500,000,000	6%	1,515,000,000	1,530,150,000	
b	Tarifa e parkimit te automjeteve	505,603,000	574,603,000	2%	626,334,000	681,570,000	
b.1	Parkim me kontratë	145,603,000	156,400,000	1%	164,110,000	173,102,000	
b.2	Parkim me bileta	360,000,000	418,203,000	2%	462,224,000	508,468,000	
c	Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	432,000,000	432,000,000	2%	432,000,000	432,000,000	
d	Tarifa dhenie licence tregtimit karburanti +Lende djegese	0	0	0%	0	0	
e	Tarifa për zënien e hapësirave publike	172,638,000	300,000,000	1%	303,000,000	306,030,000	
e.1	Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella.	152,638,000	280,000,000	1%	282,600,000	285,222,000	
e.2	Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	20,000,000	20,000,000	0%	20,400,000	20,808,000	
f	Tarifa e shërbimit veterinarë	5,320,000	5,690,000	0%	7,945,000	3,360,000	
g	Tarifa shërbimi te MZSH	7,500,000	8,600,000	0%	9,000,000	9,500,000	
2	Të ardhura të tjera	813,000,000	813,000,000	3%	813,000,000	813,000,000	
a	Te ardhura nga qerate	63,000,000	63,000,000	0%	63,000,000	63,000,000	
b	Te ardhura te institucioneve te varesise	150,000,000	150,000,000	1%	150,000,000	150,000,000	
c	Te ardhura te tjera (penalite te administrative; te padetajuara; etj.)	600,000,000	600,000,000	3%	600,000,000	600,000,000	
3	Pagesa	234,400,000	236,736,000	1%	236,736,000	236,736,000	
a	Per kopshtet e femijeve	151,000,000	152,384,000	1%	152,384,000	152,384,000	
b	Per çerdhet e femijeve	78,800,000	80,152,000	0%	80,152,000	80,152,000	
c	Per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,600,000	4,200,000	0%	4,200,000	4,200,000	
	Shuma	14,215,436,000	14,407,253,000	61%	14,524,930,000	14,636,228,000	
	Transferata e pakushtezuar e pergjithshme	2,438,116,570	2,523,450,650	11%	2,550,000,000	2,600,000,000	
	Transferata e pakushtezuar sektoriale	2,331,955,992	1,269,437,150	5%	1,300,000,000	1,350,000,000	
	Të ardhura të mbartura	4,225,588,463	5,400,000,000	23%	2,500,000,000	2,000,000,000	
	Totali i të ardhurave	23,211,097,025	23,600,140,800	100%	20,874,930,000	20,586,228,000	
I.	Shpenzime Korrente	14,804,489,487	13,626,158,699	1	13,218,192,001	13,745,687,025	
1	Personeli (Paga dhe Sigurime Shoqerore)	6,555,843,612	6,574,274,533	28%	6,574,274,533	6,574,274,526	
2	Shpenzime per interesa		0	0%	0	0	
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	7,643,109,507	6,314,496,518	27%	6,167,363,068	6,682,586,099	
4	Transferata Individe	388,376,103	315,727,000	1%	345,500,000	400,500,000	
5	Transferata të brendshme	217,160,265	421,660,648	2%	131,054,400	88,326,400	
6	Transferata jashtë			0%			
II.	Fondi Rezervë, Kontigjenca	188,346,500.000	190,000,000.000	1%	220,000,000.000	260,000,000.000	
1	Fondi Rezervë	138,346,500.000	150,000,000.000	1%	170,000,000.000	200,000,000.000	
2	Fond Kontigjenca	50,000,000.000	40,000,000.000	0%	50,000,000.000	60,000,000.000	
III	Shpenzime Kapitale	8,218,261,038	9,783,982,101	41%	7,436,737,999	6,580,540,975	
	Financim i Brendshëm			0%			
	Totali i shpenzimeve	23,211,097,025	23,600,140,800	100%	20,874,930,000	20,586,228,000	